

Forum 2015

DIASPORA DHE POLITIKAT E MIGRACIONIT

Ky studim është përgatitur për Forum 2015 nga Instituti Riinvest bazuar në hulumtimin e zhvilluar në Kosovë, Gjermani, Zvicër, Belgjikë, Mbretëri të Bashkuar, Suedi, Austri dhe SHBA

Dhjetor 2007
Prishtinë

Ekipi i projektit:

Muhamet Mustafa
Mrika Kotorri
Petrit Gashi
Ardiana Gashi
Venera Demukaj

Ekipi i anketimit dhe diskutimeve në grupe të fokusuara:

Ymer Havolli
Afërdita Berisha
Saxhide Mustafa
Durim Hoxha
Valza Kika
Arian Shala

Konsulentë:

Richard Beilock, University of Florida University, USA
Muhamet Sadiku, Riinvest
Ken Jackson, Auckland University, New Zealand
Rifat Blaku, University of Prishtina

Botues: Forum 2015
Përkrahur nga: Fondacioni i Kosovës për Shoqëri Civile, Instituti Riinvest,
Balkan Trust for Democracy dhe Friedrich Ebert Stiftung
Shtyp: Kelmendi Papier
Tirazhi: 500

PËRMBAJTJA

7 PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

11 REKOMANDIMET

13 HYRJE

15 DIASPORA DHE REMITANCAT – NDIKIMET POTENCIALE NË EKONOMIMË E KOSOVËS

Një Vështrim I Efekteve Zhvillimore Të Diasporës Dhe Remitancave
Implikimet Pozitive Të Diasporës Dhe Remitancave
Mangësitë E Diasporës Dhe Remitancave
Përvojat E Vendeve Të Tjera Me Diasporën Dhe Remitancat

27 DIASPORA E KOSOVËS – PROFILI SOCIO-EKONOMIK DHE RËNDËSIA E SAJ

Historiku I Shkurtër I Mërgatës Kosovare
Profili Demografik Dhe Socio-ekonomik I Diasporës Kosovare
Statusi Dhe Kushtet Tjera Në Vendet E Adoptuara
Vendi Nikoqir
Statusi Ligjor Në Vendin Nikoqir
Planet Për Kthimi
Kushtet Ekonomike Të Emigrantëve
Punësimi
Të Ardhurat

35 NDIKIM EKONOMIK AKTUAL DHE POTENCIAL I DIASPORËS

Remitancat Dhe Format E Tjera Të Ndikimit Të Drejtpërdrejtë
Matja E Remitancave Dhe Kontributeve Të Tjera
Rëndësia Kritike E Remitancave Për Familjet Kosovare
Remitancat Dhe Zbutja E Varfërisë
Investimet E Diasporës, Situata Aktuale Dhe Potenciale
Remitancat Dhe Zbutja E Varfërisë
Investimet E Diasporës, Situata Aktuale Dhe Potenciale
Prona, Afarizmi Dhe Pasuritë E Tjera Në Kosovë

47 ASPEKTET INSTITUCIONALE DHE LIDHJET ME DHE NDËRMJET DIASPORËS

Lidhjet Me Familjet
Komunikimi Me Autoritetet Kosovare Dhe Përkrahja E Tyre
Fushat Problematike
Veprimet Administrative Për Të Adresuar Brengat E Diasporës
Arsimi
Organizimi I Diasporës Dhe Fragmentimi Politik
Përfshirja Në Zhvillimin E Qeverisjes Në Kosovë
Komunitetet E Diasporës
Drejt Ndërtimit Të Politikave Aktive Të Emigracionit
Potenciali Emigrues
Politikat Aktive Të Emigracionit Drejt Tregut Evropian Të Punës

ANEKS:

Aneks 1: Përfundimet e arritura nga diskutimet në grupe të fokusuara

Mungesë e politikave dhe organizimit të qëndrueshëm të diasporës

Remitancat, trendi dhe perspektiva e tyre

Rrjetet afariste

Institucionet dhe lidhjet e shkëputura me Kosovën

Turizmi i diasporës

Biznesi dhe komunikimi

Zbatimi i ligjit dhe korrupsioni

Imazhi i Kosovës

Aneks 2: Intervistat me investitorët nga diaspora

Kompania 1: Trofta

Kompania 2: Kosova Steel

Kompania 3: Kombinati i Drurit

Një investitor potencial nga diaspora, por hesitant për të investuar në Kosovë

BIBLIOGRAFIA

PËR FORUM 2015

LISTA E AKRONIMEVE DHE SHKURTESAVE

TBD – Trusti Balkanik për Demokraci
AQBK – Autoriteti Qendror Bankar i Kosovës
IÇK – Indeksi i Çmimit të Konsumatorit
EAQ – Evropa dhe Azia Qendrore
BE – Bashkimi Evropian
RPH – Raporti i Paralajmërimit të Hershëm
IJD – Investimet e Jashtme Direkte
BPV – Bruto Produkti Vendor
BNRZH – Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim
TIK – Teknologjia e Informatikës dhe Komunikimeve
FMN – Fondi Monetar Ndërkombëtar
TI – Teknologjia Informatike
FKSHH – Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur
AKM – Agjencia Kosovare e Mirëbesimit
OJQ – Organizatat Joqeveritare
OBKE – Organizata për Bashkëpunim dhe Kooperim Ekonomik
ESK – Enti i Statistikave i Kosovës
BM – Britania e Madhe
SHBA – Shtetet e Bashkuara të Amerikës
BB – Banka Botërore

LISTA E TABELAVE

Tabela 1: Indikatorët kryesorë makroekonomikë në Kosovë (2005 – 2007)
Tabela 2: Shpërndarja e emigrantëve në bazë të vendeve nikoqire
Tabela 3: Statusi ligjor në vendet nikoqire
Tabela 4: Punësimi në bazë të vendeve nikoqire
Tabela 5: Punësimi në bazë të sektorit
Tabela 6: Niveli i punësimit
Tabela 7: Pjesa e emigrantëve, ndarë në bazë të intervaleve të të hyrave mujore
Tabela 8: Numri i emigrantëve kosovarë dhe sa shpesh ata dërgojnë para
Tabela 9: Shpeshësia e dërgesave të parasë
Tabela 10: Shumat e dërguara nga diaspora kosovare
Tabela 11: Vlerësimi i kontributeve financiare dhe në mallra nga diaspora: Kosova, 2007
Tabela 12: Sa shpesh e vizitojnë Kosovën?
Tabela 13: Përqindja e përgjithshme e remitancave të pranuar në bazë të intervaleve të të hyrave
Tabela 14: A keni investuar në ndonjë afarizëm apo në infrastrukturë në Kosovë?
Tabela 15: Arsyet që nuk keni planifikuar të investoni në Kosovë
Tabela 16: Problemet e hasura nga diaspora me institucionet kosovare
Tabela 17: Mendimet e diasporës lidhur me organizatat e diasporës
Tabela 18: Arsyet parësore për të pasur dëshirë për të emigruar
Tabela 19: Destinimet e dëshiruara prej atyre që duan të emigrojnë

LISTA E FIGURAVE

Figura 1: Remitancat si pjesë e BPV në vendet në transicion, 2004
Figura 2: Ndikimi ekonomik i diasporës dhe emigrantëve qarkullues në vendin amë
Figura 3: Krahasimi i strukturave të shpenzimit të remitancave në 6 vende të EAQ-së dhe Kosovës
Figura 4: Strukturat e shpenzimit të remitancave

LISTA E KUTIVE

Kutia 1: Diaspora e serbëve të Kosovës
Kutia 2: Diaspora dhe pakënaqësitë e saj
Kutia 3: Mësimdhënësi

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Krijimi i politikave të përshtatshme në lidhje me emigracionin dhe statusin e diasporës kosovare ka një rëndësi kyçe për nxitjen e rritjes ekonomike dhe zvogëlimin e shpërpjesëtimeve makroekonomike në Kosovë. Nëpërmjet zbatimit të politikave të tilla, diaspora do të mund të kontribuonte në mënyrë më efektive në ngritjen e kapitalit njerëzor dhe financiar, në rritje ekonomike dhe në krijimin e vendeve të reja të punës në Kosovë. Ky raport ofron informacione lidhur me diasporën dhe nënvizon sfidat dhe mundësitë e pjesëmarrjes më domethënëse të diasporës në përmirësimin e gjendjes ekonomike dhe zhvillimin ekonomik të Kosovës. Në këtë raport posaçërisht janë trajtuar çështjet si: madhësia dhe profili socio-ekonomik i diasporës; kontributi i saj i tanishëm përmes remitancave, investimeve, kontributet me furnizimin me mallra të ndryshme, "turizmit" të diasporës; organizimi i institucioneve kosovare karshi diasporës dhe niveli në të cilin këto institucione adresojnë nevojat dhe interesat e tyre; cilat politika duhet të zbatohen që të rrisin ndikimin dhe kontributin social, njerëzor dhe financiar të diasporës, si dhe politikat e përshtatshme të emigracionit që do të ishin konsistente me kushtet e tanishme socio-ekonomike, si dhe me zhvillimet e pritura në procesin e integrimi në BE dhe në tregun e punës të saj.

Hulumtimet e bëra për të hartuar këtë raport përfshijnë: një anketë me 1,091 vizitorë në Kosovë, të zgjedhur me metodën e rastit nëpër pikat kufitare; një anketë me 1,537 familje (përfshirë 200 familje serbe) në Kosovë; 12 diskutime në grupe të fokusuar me pjesëtarë të diasporës (91 pjesëmarrës), në Gjermani, Zvicër, Belgjikë, Britani të Madhe, Suedi, Austri dhe SHBA (kryefamiljarë, afaristë dhe intelektualë); si dhe intervista më të detajuara me zyrtarë të institucioneve relevante kosovare dhe investitorë nga diaspora. Gjithashtu, është rishikuar literatura bashkëkohore që adresojnë këto çështje.

Rezultatet e anketave tregojnë se afërsisht 17% e kosovarëve jetojnë jashtë shtetit. Duke supozuar se popullata e përgjithshme (rezident dhe nga diaspora) është 2.5 milionë, atëherë vlerësohet se madhësia e diasporës është afërsisht 315.000 shqiptarë të Kosovës dhe 100,000 serbë dhe kombësi të tjera të Kosovës. Rreth 30% e familjeve kosovare kanë një apo më shumë anëtarë të familjes që jeton jashtë vendit. Shumica e emigrantëve jetojnë në Gjermani 39%, Zvicër 23%, Itali dhe Austri 6-7% secili, Britani e Madhe dhe Suedi 4-5% në secilin, SHBA 3.5% dhe në Francë, Kanada dhe Kroaci nga 2% në secilin vend. Diaspora mund të ndahet në bazë të kohës së emigrimit: emigracioni i vjetër, gjatë viteve të 60-ta deri në vitet e 80-ta, llogaritet të jetë 14%; numri i atyre emigrantëve që janë larguar gjatë periudhës së represionit gjatë viteve të 90-ta llogaritet të jetë 59% dhe pjesa tjetër e diasporës prej 27%, kanë emigruar nga Kosova gjatë luftës. Afërsisht 5% e diasporës ka lindur jashtë Kosovës.

Regjione të caktuara të Kosovës, prej nga një përqindje e jashtëzakonshme e popullsisë ka emigruar, përfshijnë: Ferizajn, Gjakovën, Gjilanin dhe Prizrenin. Ngjashëm me strukturën në Kosovë, diaspora është mjaftë e re në moshë me një mesatare prej 28 vjetësh. Sidoqoftë, struktura gjinore e tyre është e ndryshme prej popullacionit të gjithmbarshëm. Afërsisht dy të tretat e diasporës

janë meshkuj. Shumica e diasporës (46%) ka shkollim të mesëm dhe afërsisht 10% e tyre kanë shkollim të lartë. Mbi 22% e tyre kanë përfunduar një pjesë të shkollimit në ndonjë vend tjetër. Shumica e diasporës (60%) kanë nënshtetësi të vendeve ku jetojnë, pjesa tjetër (34%) kanë leje të përkohshme të qëndrimit (2-10 vjeçare), nga të cilët 1.3% kanë viza studentore. Afro 4% e emigrantëve e kanë të padefinuar statusin ligjor.

Rreth 58% e diasporës janë të punësuar në vendet ku banojnë. Nga këta, 33% janë të punësuar në ndërtimtari, 11% në restorante dhe hotele dhe 11% në fabrika. Pjesa tjetër janë të punësuar në bujqësi apo industri tjera shërbyese. Vetëm afro 7% e atyre që punojnë kanë pozita udhëheqëse/mbikëqyrëse. Paga mesatare është afro 1,700 Euro. Të hyrat mesatare në buxhetet familjare të atyre që jetojnë me familjet e tyre jashtë (rreth 68% bazuar në anketat e vizitorëve), është afërsisht 3,000 euro.

Ndikimi/kontributi i diasporës në Kosovë është domethënës. Afërsisht 70% e emigrantëve dërgojnë remitanca te familjet e tyre në Kosovë. Pak më pak se çdo e pesta familje në Kosovë pranojnë remitanca. Nga këto familje, afërsisht 13% e tyre kanë marrë vetura, 48% e tyre veshëmbathje dhe tekstil dhe 13% e tyre pajisje të ndryshme elektronike. Shtatëdhjetë për qind e emigrantëve e vizitojnë Kosovën, duke ndikuar në rritjen e konsumit të përgjithshëm përmes shpenzimeve të bëra gjatë vizitës.

Bazuar në hulumtimin tonë, vlerësohet se të hyrat vjetore nga diaspora janë: (a) remitanca në para të gatshme, €170 milionë, (b) kontributet në mallra dhe gjësende që sjellin, €22 milionë dhe (c) kontributi i vizitorëve - "Turizmi i diasporës" afërsisht €125 milionë. Të hyrat totale sillen rreth €317 milionë, apo përafërsisht 14% të BPV të Kosovës. Bazuar në diskutimet me grupe të fokusuara, deri më 2004, remitancat janë zvogëluar për rreth 30% krahasuar me periudhën e para luftës. Gjatë dy/tre vjetëve të fundit, niveli i remitancave ka shënuar një rënie të vogël. Lidhur me periudhën e ardhme afatmesme, te diaspora mbizotëron mendimi se niveli i remitancave do të mbetet përafërsisht i njëjtë. Përcaktuesi kryesor i lartësisë së dërgesave financiare (remitancave) dhe i shpeshtësisë së remitancave është perceptimi i emigrantit për nevojat dhe situatën ekonomike të familjeve të tyre në Kosovë.

Afërsisht gjysma e remitancave në para të gatshme janë përdorur për konsum (pak a shumë si në vendet e tjera të EAQ-së), afërsisht 18% janë përdorur për ndërtim të shtëpive dhe riparime, 17% për qëllime shëndetësore, 15% për arsim dhe vetëm një pjesë modeste prej 3% përdoren për investime në afarizëm (më pak se në vendet e tjera të EAQ-së). Ndikimi i këtyre kontributeve është domethënës në përmirësimin e shpërpjesëtimeve të mëdha të Kosovës në tregtinë e jashtme dhe tregun e punës. Sidoqoftë, efekti nxitës (multiplikues) në krijimin e rritjes ekonomike dhe vendeve të reja të punës nuk është në përpjesëtim me lartësinë e kontributit të diasporës në forma të ndryshme, për shkak të shpërpjesëtimeve të mëdha në tregtinë e jashtme. Të hyrat nga diaspora kryesisht shpenzohen për konsumimin e të mirave të importuara; për importimin e lëndës së parë për ndërtimtari dhe e njëjta vlen për shërbimet shëndetësore.

Aktiviteti ndërmarrës i diasporës është ende në nivele modeste. Afërsisht 4% e tyre kanë bizneset që veprojnë në vendet ku jetojnë apo në Kosovë. Ata të cilët investojnë në Kosovë, siç edhe pritet, kanë tendencë më të madhe për ta vizituar atë. Çdo i pesti emigrant që iu nënshtrua anketës së vizitorëve dëshmon se ka bërë investime në Kosovë. Shumica e këtyre investimeve janë në ndërtimtari (73%), 14% të tjera janë në aktivitete komerciale, ndërsa të tjerat në shtëpi private. Megjithatë, pjesëmarrja e diasporës në privatizim duket se ka qenë e rëndësishme. Së paku reth 10% e fondeve të krijuara nga privatizimi vlerësohet se kanë ardhur nga burimet e diasporës, gjë që dëshmon se diaspora ka kontribuar në procesin e privatizimit.

Përgjatë diasporës, ka perceptime dhe brengat të ngjashme me komunitetin e biznesit në Kosovë, lidhur me klimën e investimeve dhe zhvillimit të afarizmit. Në këtë aspekt, diaspora është mjaft kritike lidhur me korrupsionin dhe praktikën e pavolitshme burokratike në administratë. Ekziston një bindje e gjerë në diasporë se për të rritur tërheqjen e shtuar të investimeve krahasuar me shtetet fqinje, duhet një përmirësim domethënës i politikave dhe kualitetit të qeverisjes.

Anëtarët e diasporës shprehin brengën dhe pakënaqësinë e thellë lidhur me "mungesën e kujdesit dhe vëmendjes" nga institucionet qeveritare të Kosovës ndaj problemeve që ata hasin në vendet ku jetojnë. Për më tepër, ekziston mendimi se Qeveria e Kosovës bën shumë pak që të lehtësojë mënyrat e udhëtimit dhe të mbrojtë të drejtat e tyre, përderisa në anën tjetër përfiton nga turizmi i diasporës dhe kërkon nga ata që të rrisin investimet dhe remitancat në Kosovë. Me fjalë tjera, diaspora ndihet se është lënë pas dore nga administrata, e cila "ka harruar kontributin e tyre për mbijetesën" të Kosovës gjatë kohëve të vështira të viteve të 90-ta. Këto ndjenja duhet të trajtohen në mënyrë serioze nga institucionet e Kosovës. Ato duhet të ndërtojnë politika që do të mundësojnë komunikim dhe kooperim më të mirë dhe mekanizma efektivë që do të adresojnë nevojat e diasporës. Duke pasur nevojë të madhe për t'u rritur ekonomikisht dhe për të krijuar vende të reja pune, Kosova nuk guxon të neglizhojë potencialin e rëndësishëm të diasporës. Puna me diasporën mund t'i ndihmojë Kosovës që të përmirësojë imazhin e saj jashtë vendit dhe kjo mund të lehtësojë investimet dhe përkrahjen tjetër që mund të vijë jashtë diasporës. Organizimi dhe mobilizimi i diasporës së Kosovës është përkeqësuar pas çlirimit të Kosovës. Shumë respondentë konsiderojnë se organizimet aktuale partiake përfaqësojnë një anakronizëm dhe i kontribuojnë fragmentimit dhe mungesës së organizimit dhe komunikimit ndërmjet komunitetit kosovar jashtë vendit.

Aktualisht Kosovës i mungojnë politikat lidhur me emigrimet. Është e kuptueshme se në një papunësi rreth 40%, ekziston një potencial i lartë për emigrim. Rreth gjysma (49.8%) e grupmoshës 20-35 vjeçe kanë tendencë për emigrim (EWR #18). Thuajse ekskluzivisht, motivi i emigrimit është situata ekonomike në familjet e tyre. Kjo mund të vështirësohet nëse kushtet për rritje ekonomike dhe krijim të vendeve të reja të punës nuk përmirësohen në mënyrë substanciale. Në këtë situatë, krijimi i kushteve për emigrim dhe punësim të organizuar (qarkullues), sidomos në vendet e BE-së, është bërë çështje urgjente. Me përcaktimin e statusit politik dhe progresit drejt integritetit në BE, Kosova do të kishte të drejtë që të merrte pjesë në kuotat e BE-së për punësim të përkohshëm (emigrim qarkullues). Aktualisht, kjo pjesërisht funksionon me Slloveninë për punë-

torët e ndërtimtarisë. Aktualisht Kosova nuk i shfrytëzon kuotat potenciale për punësim të përkohshëm në vendet e BE-së. Nga një deficit i pritur në tregun e punës në BE në dekadat në vazhdim, Kosova si dhe BE-ja do të mund të përfitonin nga emigrimi qarkullues (i përkohshëm). Kjo mundësi duhet të adresohet përmes politikave aktive të tregut të punës, posaçërisht përmes zhvillimit dhe implementimit të drejtë të programeve dhe trajnimeve të duhura në mënyrë që të përmbushen kërkesat e tregut të punës së vendeve evropiane.

REKOMANDIME

1. Marrja e masave për ngritjen e kontributit të diasporës në zhvillimin ekonomik dhe social:
 - a. Agjencia për Promovim të Investimeve do të duhej të krijonte kanale të posaçme komunikimi për të informuar kosovarët në diasporë për mundësitë e investimeve në Kosovë (përmes internetit, buletineve, konferencave, panairove për promovim të investimeve, kontakteve direkte).
 - b. Të shqyrtohet qëndrueshmëria e themelimit të fondeve investive të diasporës, si mënyrë e koncentrimit të burimeve të investimeve të kosovarëve jashtë vendit, të cilët janë të interesuar të kontribuojnë në zhvillim, njëkohësisht duke siguruar përfitim më të mirë nga investimet e tyre.
 - c. Të mbështetet komunikimi më i mirë midis biznesmenëve kosovarë që veprojnë në vende të ndryshme, krijim i rrjeteve të tyre dhe ndërlidhjes me asociacionet e biznesit në Kosovë dhe me Qeverinë e Kosovës.
 - d. Do të duhej të krijohet një bazë e të dhënave që do të përfshinte bizneset kosovare në diasporë.
 - e. Të ndërtohet një bazë e të dhënave që do të përfshijë potencialet intelektuale të diasporës. Të krijohet një komunikim më i mirë mes institucioneve të Kosovës dhe diasporës, me qëllim që ata të angazhohen përkohësisht në ministritë dhe universitetet përkatëse.
 - f. Veçanërisht është e nevojshme që urgjentisht të bëhen përmirësime dhe programe konkrete të përqendruara në pritjen më të mirë të emigrantëve dhe diasporës gjatë vizitave të tyre në Kosovë, veçanërisht gjatë pushimeve verore. Këto duhet të përfshijnë: (a) Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të përkrahë projekte që do të zbatohen nga insitucionet arsimore – shkolla verore dy-tri javore për fëmijë dhe të rinj; (b) Përkrahje për aktivitetet e agjencive turistike për të ofruar vizita të organizuara në vende historike, kulturore, dhe rekreative; (c) Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit të organizojë dhe të përkrahë ngjarje kulturore dhe sportive gjatë kohës së pushimeve, kur vizitorët nga diaspora zakonisht e vizitojnë Kosovën më shumë.
2. Të përmirësohet komunikimi dhe organizimi i institucioneve me diasporën në lidhje me shqyrtimin e problemeve të tyre:
 - a. Të zhvillohen më tej kapacitetet e Departamentit për Çështje Jorezidente në kuadër të Zyrës së kryeministrit për të koordinuar aktivitetet e insitucioneve qeveritare për zbatimin e politikave që lidhen me diasporën.
 - b. Të përkrahët plotësisht zbatimi i projektit të Ministrisë së Punëve të Brendshme për të siguruar që të gjitha procedurat për lëshimin e dokumenteve personale edhe atyre të udhëtimit të jenë efektive, të shpejta, dhe pa pengesa të panevojshme administrative.
 - c. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë do të duhej të analizonte mundësitë për përkrahje të arsimit plotësues/shtesë të fëmijëve nga diaspora për gjuhë, histori, gjeografi dhe art.

3. Të organizohet një tryezë e rrumbullakët e presidentit të vendit dhe kryeministrit me partitë politike, për të tejkaluar ndarjet politike dhe për të eliminuar organizimet e diasporës në baza partiake. Në vend të kësaj duhet mbështetur organizmin përmes aktivitetet kuturore, edukative dhe biznesore.
4. Marrja e masave për të përmirësuar imazhin e diasporës kosovare dhe imazhin e Kosovës në vendet ku ata jetojnë:
 - a. Të promovohet përgjigja e organizuar, e kualitetit të lartë dhe e shpejtë nga institucionet e Kosovës, organizatat e diasporës dhe intelektualët për prezantim jo të drejtë të kosovarëve dhe Kosovës në medie.
 - b. Të zhvillohen aktivitete, të cilat përmirësojnë integrimin e kosovarëve në shtetet e huaja ku jetojnë dhe përmirësojnë imazhin e Kosovës (p.sh. aktivitete të përbashkëta me komunitete të ndryshme brenda këtyre vendeve).
 - c. Të ngritet angazhimi i komunitetit të diasporës me qëllim të ndikimit pozitiv të kosovarët që të zvogëlohet numri i rasteve të shkeljes së ligjit nga ana e tyre në vendet ku jetojnë.
5. Ndërtimi i politikave të emigracionit për Kosovën:
 - a. Menjëherë pasi të zgjidhet statusi i Kosovës, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale duhet të bëjë marrëveshje me vendet e BE-së dhe organizmat e saj për të siguruar përfshirje adekuate të Kosovës në kuotat për emigrim dhe punësim të organizuar të përkohshëm në ato vende (migrim qarkullues).
 - b. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe ajo e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë duhet që në bashkëpunim me donatorët të zhvillojnë programe për shkollim të rregullt dhe arsimim dhe trajnim profesional sipas nevojave aktuale dhe të ardhshme të tregut të punës në BE.
6. Të sigurohet e drejta mbi nënshtetësi të dyfishtë për emigrantët dhe diasporën tonë.

HYRJE

Përpilimi i politikave për emigracion dhe statusi i kosovarëve në diasporë kanë rëndësi për nxitjen e rritjes ekonomike dhe zvogëlimin e shpërpjesëtimeve makroekonomike në Kosovë. Me ndërtimin e politikave dhe mekanizma nxitës më efektivë dhe të përshtatshëm, diaspora do të mund të kontribuonte shumë më tepër si në aspekt të kapitalit njerëzor dhe burimeve financiare për rritje ekonomike dhe krijim të vendeve të punës në Kosovë. Ky raport ofron informata për diasporën dhe vë në pah sfidat dhe mundësitë për përmirësimin e pjesëmarrjes së diasporës në përparimin ekonomik dhe shoqëror të Kosovës. Me gjithë rëndësinë e saj, diaspora dhe politika e emigracionit deri tani nuk janë studiuar sistematikisht nga politikëbërësit dhe akterët e tjerë. Si rezultat, ka një spektër të gjerë, madje edhe kontradiktor, të informatave nga burime të ndryshme sa i përket diasporës dhe kontributit të saj në Kosovë. Për të përmirësuar këtë, Instituti Riinvest ka bërë një hulumtim gjithëpërfshirës në këto çështje. Jemi përqendruar veçanërisht, në këto çështje:

- (1) Madhësia dhe profili socio-ekonomik i diasporës.
- (2) Kontributet aktuale të diasporës përmes remitançave (duke përfshirë edhe sjelljen e mallrave dhe gjësëndeve), investimeve dhe 'turizmit' të diasporës.
- (3) Organizimi aktual i institucioneve të Kosovës në relacion me diasporën, a ka ndonjë lidhje institucionale dhe cili është perceptimi i diasporës kosovare për këtë çështje.
- (4) Mësimet nga përvoja e vendeve të tjera me diasporë.
- (5) Çfarë politikash do të duhej të zbatohen për të ngritur ndikimin pozitiv të kontributit shoqëror, njerëzor dhe financiar të diasporës së Kosovës.
- (6) Nevojat për zhvillimin e politikave të duhura të emigracionit, duke marrë parasysh kushtet socio-ekonomike të karakterizuara me papunësi të gjeneratave të reja si dhe zhvillimet e pritura në proceset e integritimeve evropiane.

Hulumtimet që janë bërë për këtë raport përfshijnë:

- (a) Dy anketa: (1) 1,091 vizitorë të zgjedhur sipas rastit në pikat kufitare në prag të festave të Vitit të Ri (2006) dhe (2) 1,537 familje në Kosovë sipas një mostre të stratifikuar sipas etnitetit dhe rajonit.
- (b) Grupe të fokusuara dhe intervista të përqendruara me kryefamiljarë (katër grupe të fokusuara me 36 pjesëmarrës), biznesmenë (tri grupe të fokusuara, 18 pjesëmarrës), intelektualë (dy grupe të fokusuara, 15 pjesëmarrës), dhe pjesëtarë të gjeneratës së dytë/tretë të diasporës (tri grupe të fokusuara, me 22 pjesëmarrës) të realizuara në Gjermani, Zvicër, Belgjikë, Mbretëri të Bashkuar, Suedi, Austri), shih Aneksin 1.
- (c) Intervista me zyrtarë të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ministrisë së Kulturës, Rinisë, Sportit dhe Çështjeve Jorezidente, Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Ministrisë së Brendshme, si dhe me zyrtarë ndërlidhës të Sllovenisë, Belgjikës dhe Italisë (me fokus të veçantë në emigrimin e organizuar të përkohshëm cirkular). Intervista janë bërë edhe me përfaqësues të AQBK-së dhe FMN-së.

(d) Hulimtimi i literaturës në lidhje me diasporën.

Raporti është strukturuar në këtë mënyrë. Kapitulli në vazhdim përmban një përmbledhje të shkurtër të literaturës për ndikimin potencial të diasporës dhe remitançave. Një përmbledhje për emigrimin në Kosovë dhe rezultatet kryesore të anketave sa i përket profilit demografik dhe socio-ekonomik të diasporës prezantohen në kapitullin 3. Kapitulli 4 analizon ndikimin aktual dhe potencial të diasporës. Kapitulli i fundit trajton aspektet insitucionale dhe lidhjet me dhe në mes diasporës.

Insituti Riinvest falënderon Forumin 2015, KFOS-in, BTD (Trusti Ballkanik për Demokraci) i German Marshall Fund dhe Friedrich Ebert Stiftung për përkrahjen, bashkëpunimin dhe mirëkuptimin e tyre.

Riinvesti gjithashtu falënderon të gjithë ata që kanë kontribuar në mënyra të ndryshme gjatë këtij projekti përmes intervistave, diskutimeve në grupet e fokusuara dhe takimeve të shkëmbimit të mendimeve dhe ideve. Posaçërisht falënderojmë Prof. Richard Beilock (Universiteti i Floridës, SHBA) dhe Kenneth Jackson (Universiteti i Auckland, Zelanda e Re) për bashkëpunimin dhe komunikimin e tyre me ekipin hulumtues të Riinvestit gjatë përgatitjes së këtij raporti.

Riinvesti e çmon shumë kontributin e të gjithë atyre që janë përfshirë në këtë projekt, mirëpo ai merr përgjegjësi të plotë për rezultatet e hulumtimeve dhe konkludimet e këtij raporti.

DIASPORA DHE REMITTANCAT – NDIKIMET POTENCIALE NË EKONOMINË E KOSOVËS

Ekonomia e Kosovës ende ballafaqohet me probleme serioze. Qysh prej kohës së zhvillimit të hovshëm dhe të menjëhershëm në vitet e para të pasluftës së vitit 1999, ekonomia e Kosovës ka pasur shumë pak apo fare progres. Pavarësisht nga fakti se niveli i asistencës nga donatorët është ende i lartë, megjithëqë ky nivel i asistencës ka pësuar një trend të rënies, dhe prej vitit 2001 Kosova ka pasur shumë pak rritje ekonomike të GDP-së, përkatësisht Bruto Produkti Vendor (BPV), si dhe ka pasur një mos lëvizje/amulli të BPV për banor, siç është ilustruar në Tabelën 1. Gati gjysma e fuqisë punëtore janë të papunë; dhe sipas vlerësimeve të Institutit Riinvest (2005), niveli i papunësisë është rreth 40%. Kosova ka popullatën më të re në Evropë, me rritje të popullsisë një ndër më të shpejtin në Evropë. Për të parandaluar rritjen e mëtejme të papunësië, Kosova duhet të krijojë së paku 25,000 vende të reja të punës në vit (shih raportin e Institutit Riinvest 2003 dhe raportin e Autoritetit Bankar dhe të Pagesave të Kosovës 2007). Kjo mund të thuhet se është edhe larg kapaciteteve të projeksioneve të shumta optimiste ekonomike. Deficiti tregtar është ende shumë i madh. Eksportet vazhdojnë të jenë shumë të vogla, duke mbuluar vetëm 8% të importeve në vitin 2006¹. Gjithashtu, zvogëlimi i prezencës së bashkësisë ndërkombëtare është duke bërë presion në rënien e çmimeve. Këto presione të deflacionit janë të parashikuara për të vazhduar, bile së paku në afat të shkurtër.

Tabela 1: Indikatorët kryesorë makroekonomikë në Kosovë (2005 – 2007)

	2005	2006	2007
Popullata (në mijëra)	1,999	2,033	2,067
BPV (në mil. €)	2,238	2,270	2,303
Rritja e BPV-së (në %)	0.30	3.00	0.70
BPV-ja për kokë banori	1,120	1,117	1,114
IQK-ja (në %)	-1.40	0.70	0.40
Bilanci tregtar (në mil. €)	-1,022	-1,159	-1,126
Llogaria rrjedhëse/BPV (në %) ¹⁾	-15.00	-19.00	-20.00
Remitanca/BPV (në %) ²⁾	12.31	14.21	18.06
Ndihma e jashtme/BPV (në %)	22.00	20.00	16.00
IJD/BPV (në %)	2.59	9.92	6.87

Burimi: FMN (2007)

Shënim: viti 2006 është vlerësim preliminar, ndërsa vitet 2007 – 2010 janë projeksione; 1) Pas ndihmës së jashtme.


1 Lexuesi duhet të jetë i vetëdijshëm se të dhënat në shumë aspekte makroekonomike nuk janë plotësisht të besueshme dhe këto të dhëna duhet të interpretohen me kujdes. E njëjta vlen edhe për të dhënat e publikura nga FMN-ja (sidomos për nivelin e remitancave), të cilat kanë qenë shumë të dalluara prej viti në vit.

Përkundër të gjitha problemeve, ekonomia e Kosovës ka pasur disa arritje të konsiderueshme. Sistemi financiar është duke funksionuar mirë, dhe me gjithë çmimin e lartë të kapitalit dhe kohës së shkurtër të maturimit të borxhit, kreditë bankare në mënyrë konstante janë rritur (AQBK, 2007). Ky progres në sistemin financiar është pjesërisht si rezultat i rritjes së konkurrencës në sistemin bankar. Efektshmëria fiskale e administratës është përmirësuar dhe prej vitit 2004 buxheti i administratës nuk varet më nga ndihmat e jashtme.

Të ardhurat e buxhetit të konsoliduar të Kosovës janë tërësisht të mbuluara nga burimet e brendshme, tatimet dhe taksat e mbedhura në Kosovë (shih FMN, 2007). Gjithashtu, Kosova ka bërë një progres të madh në reformimin struktural, e posaçërisht në privatizimin e ndërmarrjeve me pronësi shoqërore (mbi 70% të aseteve (pasurisë) janë privatizuar). Sipas të dhënave nga FMN-ja, remitancat aktuale dhe në një të ardhme të parashikueshme, do të jenë një prej komponentëve kryesorë të BPV-së (Shih figurën 1).

Si përqindje e BPV-së, Kosova ishte në vendin e shtatë në vitin 2004 në Evropë dhe Azi (d.m.th. EAQ-së; apo vendet në transicion) për nga pranimi i remitancave, ndërsa në botë e 20-ta për nga pranimi i remitancave. Megjithatë, nëse marrim parasysh shifrat e remitancave si përqindje për vitet e fundit (2005-2007), atëherë Kosova do të ngritet shumë më lart në listën e shteteve që pranojnë më së shumti remitanca (për shembull, remitancat si përqindje e BPV-së në vitin 2007 vlerësohen të jenë përafërsisht pak mbi 18 për qind). Këtu duhet ta kemi parasysh se vlerësimet tona (bazuar në rezultatet e anketave dhe analizave të tjera) nuk korrespondojnë në mënyrë të plotë me vlerësimet e FMN-së. Vlerësimet tona për vitin 2007 tregojnë që niveli i remitancave në Kosovë është €317 milionë apo rreth 14 për qind të PBB-së. Në vijim, hulumtimet tona (të bazuara kryesisht në diskutimet me grupe të fokusuara të diasporës kosovare) tregojnë që në periudhën ndërmjet vitit 2005 dhe 2007 nuk ka pasur ndryshime të theksuara në nivel të remitancave, e as që parashihet të ketë ndonjë ndryshim në një të ardhme të afërt.

Figure 1: Remitancat si proporcion i shpenzimeve të përgjithshme familjare në vitin 2004



Burimi: Banka Botërore (2006); Për Kosovën FMN-ja (2007)


Shënim: Ne supozojmë që vlerësimet e S & M nuk e mbulojnë Kosovën, sepse prej vitit 1999

NJË PËRMBLEDHJE E EFEKTEVE ZHVILLIMORE TË DIASPORËS DHE REMITANCAVE

Evidenca teorike dhe empirike për vendet e tjera tregon se efektet e diasporës dhe remitancave mund të jenë domethënëse për tërë ekonominë. Skema e mundshme e veprimeve ekonomike dhe efekteve të tyre është e prezantuar në figurën 2. Në dy katrorët në të majtë janë veprimet relevante ekonomike dhe efektet nga diaspora dhe emigrantët e përkohshëm (qarkullues), ndërsa ndikimet e remitancave janë të theksuara në anën e poshtme të djathtë. Më në fund, në anën e sipërm të djathtë janë të renditura disa prej efekteve të mundshme monetare të remitancave dhe investimeve.

Në vijim gjithashtu do të japim disa konsiderata teorike në ndikimin e diasporës dhe emigrimit sipas literaturës si dhe reflektimin e tyre të mundshëm në Kosovë. Në përgjithësi, efektet ekonomike të diasporës dhe remitancave janë pozitive, mirëpo gjithashtu ekzistojnë edhe disa implikime negative të shënuara (në figurën 2, shenja plus u referohet implikimeve pozitive të diasporës dhe remitancave, ndërsa shenja minus referon të kundërtën).

Figure 2: Ndikimet ekonomike të diasporës dhe emigrantëve të përkohshëm në vendin ku kanë lindur



IMPLIKIMET POZITIVE TË DIASPORËS DHE REMITANCAVE

Remitancat

Shuma e remitancave nga emigrantët permanentë mund të ndryshojë me kohë. Fillimisht, emigrantët zakonisht e dërgojnë një pjesë të madhe të të ardhurave të tyre. Megjithatë, kur ata zhvillojnë rrjete shoqërore në vendet ku ata qëndrojnë, lidhjet me shtetet e tyre amë dhe mbështetjet financiare për këto shtete mund të zvogëlohen. Në këtë aspekt, rëndësi të veçantë ka potenciali për zvogëlim të remitancave kur familjet ribashkohen dhe lindin obligime të reja familjare në vendqëndrimet e tyre (psh. shikoni Ruggerio 2005, për sa i përket Moldavisë, dhe Gedeshi 2002, për sa i përket Shqipërisë).

Në anën tjetër, sipas definicionit, të gjitha të ardhurat e një emigranti të përkohshëm, shpenzimet neto të bashkangjitura me udhëtim dhe qëndrim larg shtëpisë, janë remitanca. Pasi që emigrantët qarkullojnë synojnë të kthehen në vendet e tyre amë, ata kanë tendencë për t'i minimizuar shpenzimet gjatë qëndrimit jashtë shtetit.

Investimet

Diaspora, posaçërisht diaspora të mëdha si ato të Kosovës, mund të përbëjnë një pjesë të madhe të investimeve të jashtme direkte, dhe për më tepër mund të jenë të gatshëm të investojnë edhe në kushte që do t'i dekurajonin investitorët e tjerë. Në këtë aspekt, rëndësi të veçantë ka fakti që investitorët nga diaspora janë shpesh ndër të parët dhe më të dukshmit pas konflikteve dhe fatkeqësive të tjera². Kjo qëndron për katër arsye: Së pari, përparësitë etnike dhe altruizmi për familje dhe miq. Thënia "bamirësia fillon në shtëpi" paraqet tendencën njerëzore për të ndierë mëshirë më të madhe ndaj atyre që më së shumti na ngjajnë vetë neve dhe me të cilët kemi marrëdhënie personale, psh. të afërm dhe miq. Si të tillë, anëtarët e diasporës mund të jenë të gatshëm të investojnë edhe nëse ekzistojnë alternativa të tjera për investime që kanë kthime më të larta dhe/ose risk më të vogël. Kjo njihet si një diskonti patriotik ("patriotic discount"), ose ndoshta me një term më të përshtatshëm për mjedisin kosovar – si një diskont etnik ("ethnic discount")³. Faktori i dytë ka të bëjë me dituri të mirë për dhe lidhjet me biznese dhe qeveri. Ka të ngjarë që

2 Ka shumë shembuj të kësaj, duke përfshirë edhe Kosovën. Tjerë shembuj përfshijnë Izraelin pas pavarësisë, Armenia në vitet e 90-at, dhe Kina në vitet e para pas hapjes për investime të jashtme.

3 Zbritjet e tilla mund të jenë shumë domethënëse. Psh. në një studim për diasporën armeniane, pjesa më e madhe e të anketuarve tregojnë vullnet të pranojnë një zbritje për të investuar në Armeni. Shumica konstatuan se zbritjet mes 20% dhe 50 % do të ishin të pranueshme, dhe përafërsisht 10% e të anketuarve kanë qenë të gatshëm të pranojnë mes 75% lirim (Hergnyan dhe Makaryan, 2007)

anëtarët e diasporës të kenë dituri për dhe lidhjet me komunitetin e biznesit dhe me qeverinë – gjë që investitorët e tjerë të huaj potencialë nuk kanë. Këto mund t'i ulin shpenzimet për të bërë biznes, dhe kështu t'u japin investitorëve të diasporës përparësi krahasuese. Arsyeja e tretë lidhet me shkathtësitë e veçanta për industritë relevante. Posaçërisht nëse ata apo prindërit e tyre vijnë nga shteti amë, ka të ngjarë që anëtarët e diasporës të kenë shkathtësi në industritë relevante për këto shtete⁴. Dhe përfundimisht, një nxitje e rëndësishme për investim është mundësia për të shfrytëzuar pasuritë e tyre atje, që kanë në disponim. Anëtarët e diasporës mund të posedojnë pasuri në vendet e tyre amë. Kjo ka veçanërisht të ngjarë nëse emigrimi tyre ka ndodhur nën presion, siç është rasti me shumicën e diasporës kosovare. Investimet që do t'i modernizonin ato pasuri do të mund të ishin mënyrat më efektive për të realizuar kthim të favorshëm.

Lehtësim i varfërisë

Nuk ka dyshim që remitancat zvogëlojnë shkallën e varfërisë. Përveç shpenzimeve për transfer, remitancat u shkojnë krejtësisht personave në vendet në zhvillim, pa filtrime nga konsulentët nga Perëndimi dhe burokracitë e rënda. Dhe shumat janë të mëdha. Në nivel botëror, qarkullimet e remitancave vlerësohen sa dy herë niveli i ndihmave ndërkombëtare(ESI,2006)⁵.

Emigrantët dhe migruesit qarkullues janë të motivuar nga përfitimet ekonomike. Nuk ka të ngjarë që shumë braktisin shtetet e tyre nëse nuk kanë pritje të arsyeshme për fitime më të larta. Për më tepër, braktisja e tyre ka efektin e ngritjes së pagave për ata që mbesin në shtetin amë (Rivera-Batiz, 2001). Ekziston një marrëveshje e përhapur që emigrimi i fuqisë punëtore të pakualifikuar ose emigrimi i përkohshëm -qarkullues ka tendenca të zvogëlojë varfërinë (psh. shikoni IBRD 2006b). Mirëpo, mendimet ndryshojnë kur është fjala për fuqinë punëtore me kualifikime dhe shkathtësi të larta. Por, nuk ka të ngjarë që efektet negative nga kjo mund t'i përmbysin ato pozitive nga remitancat (efekti i remitancave në zvogëlimin e varfërisë në Kosovë do të diskutohet më vonë).

Lehtësitë në konsum

Remitancat mund t'u ndihmojnë familjeve që pranojnë ato që të izoloohen nga tronditje ekonomike dhe të përballojnë nevojat për konsum. Remitancat janë zakonisht të ndieshme ndaj kushteve ekonomike të vendeve nga të cilat ato burojnë, të cilat mund të jenë dobët të lidhura me ngjarjet në shtetin përfitues. Përderisa remitancat u përgjigjen kushteve në shtetet përfituese, ato kanë tendenca të jenë kundër-ciklike. Kjo do të thotë se remitancat kanë tendencë të

4 Për shembull, gjenerata e parë nga Norvegjia nuk ka të ngjarë të di shumë për rritje të kallam sheqerit, por mund të ketë dituri të konsiderueshme për nxënie dhe përpunim të harengut (lloj peshku). E kundërta do të qëndronte për një emigrant kubanez. Për të ilustruar këtë, diaspora armene ka qenë veçanërisht aktive në investime në gur të çmuar dhe stoli ,turizëm, agrobiznes/përpunim i ushqimit (posaçërisht verë) dhe ndërtimtari. Të gjitha këto kanë histori të gjatë në Armeni (Hergnyan dhe Makaryan, 2

5 Sipas raportit të Bankës Botërore Global Economic Prospects, remitancat të pranuar nga vendet në zhvillim priteshin të arrijnë shumën 167 bilionë dollarë amerikanë në vitin 2005.

rriten (zvogëlohen) kur kushtet në shtetet përfituese keqësohen (përmirësohen). Përfundimisht, edhe pse ka trende afatgjatë në nivelin e remitancave, prej vitit në vit ato janë mjaft të qëndrueshme (Neyapti 2004).

Bilanci i llogarisë rrjedhëse

Remitancat, sikurse eksporti, kanë të njëjtat efekte të dobishme në qarkullimin monetar të një vendi. Me të vërtetë remitancat mund të konsiderohen si pagesa për eksport. Në raste të pagesave për migruesit qarkullues, pagesat janë për fuqi punëtore të eksportuar. Remitancat nga diaspora dhe banorët jovendorë janë pagesa për përfitime psikike për dhuruesin (psh. Beilock 2000).

Remitancat janë tepër të rëndësishme për bilancin e llogarisë rrjedhëse të Kosovës. Edhe me infuzionet e asistencës së huaj të një shume prej 25% e BPV-së, deficiti i llogarisë rrjedhëse ishte 17.3% të BPV në 2006 (CBAK, 2007). Kjo është një ndër më të lartat në regjion. Po të mos ishin remitancat, deficiti i llogarisë rrjedhëse do të afrohej deri në 40% të BPV-së⁶.

Aspekte të tjera pozitive

Diasporat mund të përshpejtojnë dhe të ndihmojnë transferimin e teknologjisë. Kjo reflektohet te një pjesë e veçantë e diasporës në industritë me teknologji të lartë në shumë vende. Përveç kësaj, diaspora mund të përmirësojë edhe praktikat e biznesit dhe të marketingut.

Për më tepër, diaspora mund të ketë rolin e ambasadorëve të vullnetit të mirë për shtetin amë. Kjo mund të ngritë reputacionin e produkteve dhe shërbimeve nga shteti amë. Ekziston dëshmi, psh, që specialistët e suksesshëm të TI-së në mesin e diasporës së Indisë kanë qenë të rëndësishëm në krijimin e imazhit pozitiv të Indisë si qendër e besueshme e TI-së (Pandey et. al., 2004). Për më tepër, diaspora aktive mund të jetë e vlefshme në sigurimin e bashkëpunimit me shtetet e tyre amë. Shumë prej tyre, për shembull, ua atribuojnë diasporës pjesën dërmuese të politikave pozitive të Amerikës veriore dhe Francës ndaj Armenisë.

Në kontekstin e efektit potencial monetar, remitancat mund të jenë të rëndësishme për të përmirësuar kushtet e marrjes se kredive nga jashtë të një kombi. Për më tepër, disa shtete (por edhe disa kompani) emetojnë obligacione të diasporës, të cilat janë instrumente financiare për të rritur rezervat në valuta të forta – konvertibile nga diaspora e saj. Obligacionet e diasporës ende nuk përdoren gjerësisht, megjithatë disa shtete kanë pasur sukses të konsiderueshëm në akumulimin e kapitalit në këtë mënyrë. Një karakteristikë e dukshme e obligacioneve të diasporës është që ato janë afatgjatë dhe si të tilla mund të përdoren për të financuar investime. Dy rastet më të suksesshme janë Izraeli dhe India. Izraeli përdor këtë instrument huazimi për të financuar investime dhe për të mirëmbajtur lidhjet me diasporën e vet. Që nga 1951, kur Izraeli për herë të parë filloi të emetojë këto obligacione, ai ka mbledhur 25 miliardë dollarë.

⁶ Për të theksuar shkallën në të cilën Kosova mbështetet në burime të jashtme, pa asistencë të huaj apo remitanca, deficiti i llogarisë rrjedhëse i Kosovës në 2006 do të tejkalonte 60% të BPV.

Në anën tjetër, India ka përdorur këtë instrument për mbështetje të bilancit të pagesave, duke mbledhur kështu 11 bilionë dollarë që nga 1991 (më gjerësisht për këtë çështje shikoni Ketkar dhe Ratha 2007)⁷.

DISAVANTAZHET (MANGËSITË) E NDIKIMIT TË DIASPORËS DHE REMITANCAVE

Humbja e aftësive/punës

Në rastin e emigrimit të përhershëm, vendi humb përgjithmonë përfitimet direkte nga aftësitë dhe puna e një emigranti⁸. Në përgjithësi, kjo humbje është më serioze atëherë kur kapitali human i emigrantit është në nivel më të lartë, duke përfshirë edukimin, përvojën, shëndetin, dhe pjesën e mbetur të ciklit të punës. Kjo është e vërtetë për dy arsye: së pari, është e mundshme që vendi ka investuar një pjesë të konsiderueshme të resurseve për të trajnuar atë individ, dhe së dyti, sa më i lartë të jetë niveli i kapitalit human, aq më e madhe do të jetë vlera e ardhshme serike e kontributit që ai individ ka mundësi të prodhojë për vendin e tij. Serioziteti i aspektit të dytë varet nga mundësitë e ekonomisë për të shfrytëzuar talentin e individit të caktuar. Nëse kthimet për aftësitë e poseduara nga individit janë të ulëta në vend, vlera e kontributit të tij/saj në ekonomi do të jetë e vogël nëse ai/ajo nuk emigron. Përfitimet e anashkaluara nga individit, i cili emigron do të jenë po aq të vogla. Një individ racional do të emigronte saktësisht për arsye të kthimeve (përfitimeve) më të larta për aftësitë e tyre në vendet e tjera. Me fjalë të tjera, individët janë të prirur të emigrojnë nga vendi kur humbjet nga ato çfarë i ofrohen në vendin e lindjes janë më të vogla, apo së paku të përrafërta me vlerën e tyre në vendet e tjera. Kjo nuk do të thotë, megjithatë, që në këtë rast nuk ka kurrfarë problemi. Individët mund të zgjedhin rrugën më të mirë për vetveten, por ata marrin me vete edhe investimet e bëra nga shoqëritë e tyre dhe për të cilat investime ato shoqëri në mënyrë të arsyeshme presin një kthim⁹.

Në të kundërtën e migracionit të përhershëm, humbja e aftësive dhe punës së një migruesi qarkullues është e përkohshme¹⁰. Rëndësia e kësaj, megjithatë, ka mundësi të jetë më e vogël për katër arsye: së pari, zakonisht, edhe pse jo gjith-

7 Shembuj tjerë të suksesit janë Sri Lanka, Afrika Jugore, dhe Libani. Ketkar dhe Ratha 2007 diskutojnë logjikën, metodologjinë, dhe faktorët që ndikojnë në emetimin e obligacioneve të diasporës.

8 Me respekt ndaj aftësive me nivel më të lartë se mesatarja, kësaj dukurie zakonisht i referohemi si ikje e trurit. (brain drain)

9 Disa vende tentojnë të diskurajojnë emigrimin e qytetarëve të tyre me nivel të lartë të aftësive. Për shembull, ka pasur tentativa për të kërkuar një periudhë pune në vend për edukimin e marrë në universitet publik. Këto përpjekje, në praktikë, janë të lehta për t'u anashkaluar dhe kanë pasur shumë pak sukses (Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, f. 67-69).

10 Punëtorët migrues janë individët që jetojnë dhe punojnë përkohësisht jashtë vendit të tyre. Ashtu sikurse këta individë largohen dhe kthehen nga vendi i tyre, këtij procesi i referohemi si "emigrim qarkullues", kurse individëve u referohemi si "migrues qarkullues".

monë, migruesit qarkullues kanë nivel të moderuar ose të ulët të aftësive; së dyti, migruesit qarkullues zakonisht veprojnë në mundësitë imediate (të menjëhershme) të gjenerimit të të ardhurave më të larta sesa ato që janë në

dispozicion në vendet e tyre. Në shumë raste, migruesit qarkullues janë të papunësuar ose të ndërpunësuar në vendet e tyre; dhe së fundi, migruesit qarkullues tentojnë të kthejnë pjesë të mëdha të fitimeve të tyre në vendet e tyre.

Bindjet morale rezultojnë në reduktim të përpjekjeve

Ekzistojnë brenga të shumta që marrësit e remitancave mund të ndikohen keq për zhvillim individual. Kjo veçanërisht mund të jetë e vërtetë, sidomos nëse rritjet në të ardhurat familjare do të mund të ndikojnë në zvogëlimin e remitancave. Atëherë të marrësi i remitancave mungon nxitësi për të krijuar vetë të ardhura dhe për të punuar. Studimi nga Hunte (2004) sugjeron që për çdo një për qind rritje në të ardhurat familjare të marrësve të remitancave, remitancat pësojnë rënie me 0.8 për qind. Duke e pranuar këtë vlerësim dhe nëse remitancat paraqesin të gjitha ose pothuajse të gjitha të ardhurat e familjes, do të ketë shumë pak nxitje për zhvillim individual. Sidoqoftë, remitancat zakonisht përbëjnë gjysmën ose më pak të të ardhurave të familjes. Nëse, për shembull, remitancat kanë qenë 40 për qind e të ardhurave të familjes, atëherë për çdo 1 për qind rritjeje përmes përpjekjeve të tyre individuale, remitancat do të pësojnë rënie në ekuivalencë prej 0.32 për qind të të ardhurave të familjes dhe kjo mund të demotivojë angazhimin e tyre për gjenerim vetiak të të ardhurave.

Vlerëritja e valutës dhe Dergja Holandeze

Siç u theksua edhe më parë, remitancat janë, efektivisht, pagesa për eksportet e punës dhe përfitimeve të tjera. Nëse ato janë në nivel të lartë, ka potencial për mbivlerësimin e valutës dhe reduktim të konkurrencës në sektorët etjerë. Kjo dukuri zakonisht referohet si Dergja Holandeze. Në rastin e Kosovës, kjo nuk është brengë e madhe, së paku në periudhë afatshkurtër dhe afatmesme, për tri arsye kryesore. E para dhe më kryesorja, Kosova shfrytëzon euron si valutë. Si e tillë, nuk ka ofertë të vogël të valutës lokale çmimi i së cilës do të mund të ngrihej në mënyrë rapide nga një influks i valutës së jashtme. Së dyti, që nga viti 2001 komuniteti ndërkombëtar në Kosovë është zvogëluar në mënyrë progresive, duke shkaktuar ulje të kërkesës agregate. Remitancat pjesërisht kanë kompensuar këtë trend. Në vitin 2001, inflacioni në Kosovë ka qenë 11.7 për qind. Që nga viti 2003, ka lëvizur mes -1.5 dhe 1.1 për qind (AQBK, 2007). Pa remitancat, Kosova do të mund të ishte në një spirale të ashpër të deflacionit për aq sa komuniteti ndërkombëtar të vazhdojë të zvogëlohet. Së fundi, fakti i keq është që nuk ka shumë hapësirë për përkeqësim të gjendjes së tregut. Produktet kosovare të eksportuara mbulojnë rreth 10 për qind të importeve.

PËRVOJAT E VENDEVE TË TJERA ME DIASPORËN DHE REMITANCAT

Sipas njohurive tona, nuk ka studime të cilat në mënyrë vendimtare demonstronjë që diaspora dhe migruesit qarkullues mund të asistojnë materialisht vendin për të arritur një rritje ekonomike të qëndrueshme. Sidoqoftë, ka disa shembuj të cilët e rrisin besimin në këtë drejtim për një rritje të qëndrueshme ekonomike. Sigurisht, tre shembujt më të mirë janë Irlanda, Izraeli dhe Armenia.

Irlanda

Së paku që nga viti 1840, Irlanda ka qenë eksportuese e njerëzve. Kohëve të fundit, që nga vitet e 70-ta, Irlanda është konsideruar të jetë vendi i dytë apo i tretë në botë, anomali në Evropën Perëndimore. Më shumë se 1,000 njerëz në ditë kanë emigruar, kryesisht në Britani. Shumë nga diaspora kanë dërguar remitanca në shtëpi, duke lehtësuar vështirësitë e atyre që kanë mbetur prapa. Mirëpo, deri në vitet e 80-ta, investimet e jashtme direkte nuk kanë marrë hov në Irlandë. Shumë nga këto kanë qenë nga SHBA-ja, zakonisht të ndërlidhura me biznesmenët nga diaspora. Në shumë vite, Irlanda e vogël ka numëruar më shumë se 10 për qind të të gjitha investimeve nga SHBA-ja në Evropën Perëndimore. Vetëm brenda një dekade, Irlanda ka kaluar nga një ndër vendet më të varfra në Evropë, te njëra ndër vendet më të pasura të saj. Duke nënvizuar këtë kthim dramatik, BPV për kokë banori e Irlandës aktualisht tejkalon atë të Britanisë së Madhe dhe Irlanda ka një rrjedhë pozitive neto të migruesve. (më shumë ardhje sesa shkuarje).

Ka shumë faktorë të cilët kanë kontribuar në ngritjen e "Tigrin Kelt". Më i rëndësishmi prej tyre është pranimi në Bashkimin Evropian, në vitin 1973, me qasje në tregjet shërbyese dhe subvencione. Përveç kësaj, ka pasur reforma të rëndësishme, të cilat kanë bërë Irlandën më atraktive për bizneset. Megjithatë, duket e vërtetë që mrekullia irlandeze është ndihmuar në mënyrë sinjifikante nga investimet të lidhura me diasporën.

Izraeli

Tregimi i Izraelit është shumë i ngjashëm me atë të Irlandës. Deri në vitet e 90-ta, Izraeli ka qenë kryesisht një vend bujqësor dhe IJD-të kanë qenë relativisht të parëndësishme (OECD, 2002). Duke filluar në vitet e 90-ta, ka pasur rritje në nivelin e IJD-ve, shumica e tyre të koncentruara në industrinë me teknologji të lartë. Rritja e Izraelit është përshpejtuar edhe mes të viteve 1990 dhe 2003, BPV e tij është rritur për 50 për qind. Nuk ka dëshmi të qarta rreth nivelit të përfshirjes së diasporës, mirëpo dominimi i investimeve nga SHBA-ja sugjeron që diaspora në këtë rast ka qenë një element i fuqishëm. Për të treguar rëndësinë e investimeve në këtë ekonomi të vogël, në bursën NASDAQ, kompanitë e huaja të listuara më së shpeshti kanë qenë nga Izraeli.

Armenia

Armenia është, ndoshta, shembulli më relevant për Kosovën. Sikurse Kosova, është e kufizuar me tokë dhe në fokus të debateve ndërkombëtare që në mënyrë potenciale zvogëlojnë atraktivitetin e saj për investime. Gjithashtu sikurse edhe Kosova, ajo ka pasur deficite të larta tregtare, ekuivalent me çerkekun e BPV-së gjatë viteve 1996 deri 2000. Që nga viti 2000, megjithatë, ekonomia e Armenisë ka qenë njëra nga ekonomitë me rritjen më të shpejtë në botë. Ngjashëm me Izraelin dhe Irlandën, reformat për të krijuar një mjedis më atraktiv për bizneset dhe për të krijuar një sektor fleksibil financiar kanë hapur rrugën dhe rritja ka qenë e ushqyer, pjesërisht, nga investimet nga diaspora dhe remitancat, si nga diaspora ashtu edhe nga migruerit qarkullues.

Ndryshimet kryesore mes të, në njërën anë, Irlandës dhe Izraelit, dhe, në anën tjetër, Armenisë ishin:

- Armenia ka filluar nga një nivel më i ulët ekonomik dhe ka qenë e ngarkuar me dëme sinjifikante të pronave, nga tërmeti i vitit 1989, si dhe nga trashëgimitë e luftës me Azerbajxhanin (25000 të vdekur, të plagosurit e luftës, dhe shpenzimet e rënda ushtarake).
- Armenia është e kufizuar me tokë dhe është më e izoluar.
- Në raport me madhësinë e ekonomisë së Armenisë, diaspora dhe migruerit qarkullues kanë qenë faktori më i madh.

Duke marrë parasysh këto fakte, Armenia i përngjanë shumë Kosovës. Transformimi ekonomik ka qenë dramatik. Sipas Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim (2007) mes viteve 1995 dhe 2005:

- BPV për kokë banori është rritur katërfish.
- Inflacioni ka rënë nga 176 për qind, në 0.6 për qind në vit.
- Deficiti fiskal është ngushtuar nga 9 për qind e BPV-së, në 2.6 për qind.
- Borxhi është zvogëluar nga 35 në 20 për qind të BPV-së.
- Deficiti tregtar është ulur nga afërsisht 1/3 e BPV-së, në nën 20 për qind.
- Varfëria është ulur prej 56 në 30 për qind, kurse varfëria ekstreme nga 21, në nën 5 për qind.

Mes viteve 2002 dhe 2007, BPV për kokë banori është rritur për më shumë se dy të tretat. Përderisa ka ende deficit tregtar të konsiderueshëm, rritja e eksportit në përgjithësi është konstante me importet dhe deficiti tregtar ka rënë nën 20 për qind të BPV-së (Roberts dhe Bainain, 2004). Rritja e shpejtë e eksporteve është me bazë të gjerë, duke përfshirë disa industri.

Roli i investimeve nga diaspora dhe remitancat kanë qenë dramatike. Mes viteve 1994 dhe 2004, 69 për qind e të gjitha investimeve të jashtme kanë qenë të ndërlidhura me kompanitë e diasporës brenda Armenisë (Hergnyan dhe Makaryan, 2007). Remitancat nga diaspora në vitin 2003 janë vlerësuar të jenë

\$324 milionë, ekuivalente me rreth 11 për qind të BPV-së. Ndoshta më së shumti, remitancat nga migruesit qarkullues kanë qenë mes \$494 dhe \$717 milionë, ekuivalente me 18 dhe 26 për qind të BPV-së (Roberts dhe Bainain, 2004).

Fijet e zakonshme përgjatë këtyre tre shembujve na përsëriten. Së pari, zhvillimi i qëndrueshëm nuk është i mundshëm pa u implementuar reformat me bazë të gjerë, të cilat krijojnë mjedis më atraktiv për bizneset. Karakteristikë e kësaj është ulja e procedurave burokratike, eliminimi i pengesave të pazakonshme për investimet e jashtme dhe luftimi i korrupsionit. Kjo lehtëson investimet, zakonisht të udhëhequra nga dhe me përfshirje të rëndësishme të diasporës. Posaçërisht gjatë transicionit drejt rritjes së lartë ekonomike, përderisa ka ende tepriçë të punëtorëve, migruesit qarkullues mund të jenë të rëndësishëm¹¹, me përfitimet shoqëruese të remitancave dhe përvetësimin e aftësive. Për të ndikuar në këtë kërkohen përpjekje të fuqishme për qeverisje të mirë, programe që përfshijnë dhe ndihmojnë angazhimin e diasporës dhe marrëveshjet me vendet e tjera për lejimin ligjor të migracionit qarkullues.

11 E vërtetë në Irlandë dhe Armeni, por jo në Izrael.

DIASPORA KOSOVARE – PROFILI SOCIO-EKONOMIK DHE RËNDËSIA E SAJ

HISTORI E SHKURTËR E EMIGRIMIT KOSOVAR

Emigrimi nga Kosova ka filluar në fund të viteve të '60-ta dhe në fillim të viteve të '70-ta dhe mund të ndahet në katër faza: 1) 1960-1988, 2) 1989-1997, 3) grupi i refugjatëve të luftës së vitit 1998/99 në Kosovë, dhe 4) 2000-2007¹². Faza e parë është karakterizuar me emigrim të punëtorëve të përkohshëm shqiptarë, kryesisht drejt Gjermanisë dhe Zvicrës. Këta emigrantë kryesisht kanë qenë "unskilled", jo aq të arsimuar dhe nga pjesët rurale. Ata janë rekrutuar me kontrata të posaçme që kanë pasur për qëllim punën e përkohshme. Megjithatë ata janë nxitur të kthehen përmes programeve të ndryshe, shumë nga këta janë lejuar të sjellin familjet e tyre në vendet ku kanë emigruar dhe kanë qëndruar atje për gjenerata (Eallace, 1998). Faza e dytë, 1989-1997, është dominuar nga emigrimi i meshkujve të rinj më të arsimuar dhe më të aftë me shkathtësi pune, nga fshatrat dhe qytetet. Këta meshkuj kanë ikur nga shërbimi ushtarak jugosllav, sidomos gjatë viteve 1992-1995. Pas rrënimit të statusit autonom të Kosovës më 1989, shqiptarët janë përjashtuar nga puna në mënyrë masive. Kjo ka vënë edhe më tepër presion në emigrimin ekonomik gjatë kësaj periudhe. Faza e tretë përfshin emigrimin e detyruar – zhvendosjen masive të popullatës – si rezultat i luftës së vitit 1998/99 në Kosovë. Shqiptarët e lëshuan vendin për t'u vendosur kryesisht në shtetet fqinje, siç janë Shqipëria (45%), Maqedonia (30%) dhe Mali i Zi (15%). Pas qershorit të vitit 1999, Kosova ka përjetuar një kthim të shpejtë të popullatës së zhvendosur. Sipas misionit të Organizatës Ndërkombëtare për Migrim (IOM) në Kosovë, gjatë periudhës 1999-2007 numri i emigrantëve të kthyer në Kosovë ka qenë 191,731. Të kthyerit, sidomos ata menjëherë pas luftës, kanë pasur rol të rëndësishëm në procesin e rindërtimit. Pas vitit 1999, politikat e imigracionit të shteteve të tjera ndaj Kosovës janë ashpërsuar, sepse Kosova konsiderohej si vend i sigurt. Gjithnjë e më shumë, ata që ishin të vendosur për të emigruar iu kthyen mënyrave ilegale. Sipas anketës me familje të vitit 2007, rreth 73% e pjesëtarëve të diasporës kanë emigruar para luftës dhe 27% pas luftës.

DIASPORA DHE PROFILI SOCIO-EKONOMIK I DIASPORËS KOSOVARE

Sipas anketës me familje të realizuar nga Riinvesti, rreth 41% të shqiptarëve kosovarë kanë anëtarë të familjes që jetojnë jashtë vendit. Kjo shifër është ulur në rreth 30% në vitin 2007 (Anketa me familje e Riinvestit 2007). Sipas vlerësimeve të Riinvestit, kjo e jep një shumë totale prej rreth 105,000 familje me emigrantë dhe rreth 315,000 emigrantë.

¹² Pasojat e luftës në ekonomitë dhe bizneset familjare – Anketa me familje e Riinvestit, 1999.

Struktura gjinore e emigrantëve është e ndryshme nga ajo e Kosovës. Derisa në Kosovë 50% të popullatës janë femra, dhe 50% janë meshkuj, 65% e emigrantëve janë meshkuj e 35% janë femra. Pjesa më e madhe e tyre janë të martuar, 64%. Madhësia mesatare e familjes është 4 anëtarë, më pak se ajo popullatës së Kosovës që është 6.4. Nga ata me fëmijë, pjesa më e madhe – 56% - kanë 3-4 fëmijë. Mosha mesatare e fëmijëve të tyre është 11.5 vjet.

Anketa tregon statistikën demografike të emigrantëve janë të ngjashme me atë të popullatës së Kosovës. Mosha mesatare e emigrantëve është 28 vjet, që është e ngjashme me mesataren e popullatës së Kosovës. Sipas anketës, ata në moshë 19-35 vjeçare ka më së shumti të ngjarë të jenë emigrantë, dhe përbëjnë 50% të numrit të përgjithshëm të emigrantëve. Ngjashmëritë në mes të dy grupeve paraqiten edhe sa i përket profilit të tyre arsimor. Rreth 46% e emigrantëve e kanë të përfunduar arsimin e mesëm, ndërsa një pjesë më e vogël, 29%, e kanë të kryer arsimin fillor¹³. Përqindja e atyre që e kanë të kryer arsimin e lartë është 10%.

KUTIA 1: DIASPORA E SERBËVE TË KOSOVËS

Në këtë boks raportohen rezultatet nga Anketa me Familje Serbe në Kosovë. Kemi anketuar 205 familje. Për dallim nga anketat me familjet joserbe, anketat e familjeve serbe kanë pasur disa pyetje specifike, për shkak të specificitetit politik të tyre. Diskutimet në këtë boks bazohen në këtë anketë. Është me rëndësi të theksohet se për shkak të mospërgjigjies në pyetjen për vlerën e remitancave/dërgesave në para të gatshme dhe në forma të tjera, nuk kemi mundur të bëjmë vlerësimin e remitancave të sjella nga diaspora serbe. Informacionet e paraqitura në këtë boks janë të dhëna nga anëtarët e familjeve të emigrantëve serbë, e jo nga vetë ata.

Tendenca për të migruar: Rreth 79 për qind e të anketuarve raportojnë se planifikojnë të emigrojnë. Nga këta 33 për qind planifikojnë të emigrojnë në Zvicër; 9 për qind në Gjermani dhe 7 për qind në SHBA dhe të tjerët nuk kanë specifikuar vendin ku dëshirojnë të emigrojnë. Për dallim nga shqiptarët e Kosovës, vetëm tetë për qind e serbëve të Kosovës përgjigjen se motivi kryesor për të migruar janë arsyt ekonomike. Arsyeja kryesore e tyre për të migruar është pakënaqësia me situatën aktuale politike.

Diaspora: të dhënat tregojnë se 18 për qind e të anketuarve (28 prej 155) kanë dikë nga anëtarët e familjes jashtë Kosovës¹⁴. Nga familjarët që kanë dikë jashtë, vetëm tetë për qind thonë se marrin remitanca. Fatkeqësisht, në këtë anketë gati asnjë nga të anketuarit nuk ka deklaruar shumën e remitancave, gjë që na pengon të bëjmë përlogaritjen e remitancave të marra nga diaspora serbe. Po ashtu, kur pyeten për ndihmat në forma të tjera jomonetare; rreth 50 për qind nuk përgjigjen fare; 25 për qind shënojnë se diaspora u sjell rroba dhe të tjerët nënvizojnë se marrin vetura, pajisje elektrike dhe barna. Problemi kryesor që familjarët mendojnë se i preokupon diasporën serbe është mosorganizimi i institucioneve të Kosovës për diasporën (14%) dhe problemet me dokumente udhëtimi (7%). Shumica nuk janë përgjigjur fare.

Profili i diasporës: Rreth 56 për qind e emigrantëve janë femra dhe 44 për qind meshkuj; mosha mesatare e tyre është 38 vjeç; 68 për qind janë të martuar dhe 81 për qind kanë shkollim të mesëm. Pak më shumë se tri të katërtat jetojnë në Serbi; 3 për qind në Mal të Zi dhe 18 për qind në vende të tjera (1 në Gjermani, 1 në Zvicër dhe 6 nuk tregojnë vendin fare). Siç mund të pritej, shumica e serbëve kanë emigruar gjatë periudhës së konfliktit të viteve 1998/99. Më në fund, të pyetur nëse familjarët jashtë Kosovës planifikojnë të kthehen në Kosovë, 95 për qind përgjigjen se ata nuk kanë plan për t'u kthyer.

13 Në Kosovë, 45% e kanë të kryer arsimin e mesëm, ndërsa 36% e kanë të kryer arsimin fillor. Profili socio-ekonomik dhe sfidat zhvillimore të Kosovës, Riinvest (2005)

14 "Jashtë" nënkupton jashtë Kosovës, por si përmendëmt më lartë kryesisht në Serbi dhe Mal të Zi.

STATUSI DHE KUSHTET E TJERA NË VENDET NIKOQIRE TË EMIGRANTËVE

Shteti i banimit

Derisa 25 vende janë shënuar nga të anketuarit si shtete nikoqire të emigrantëve (në diasporë), 60% e të anketuarve jetojnë në dy shtete, Gjermani dhe Zvicër, shih tabelën 2. Rezultate të ngjashme janë gjetur edhe në anketën me familje të vitit 1999, e cila tregon se 47.5% e emigrantëve jetojnë në Gjermani dhe 22.4% në Zvicër. Kjo besohet të jetë kryesisht pasojë e tendencës së emigrimit gjatë periudhës së parë (d.m.th. 1960-1988) të migrantëve të cilët kanë udhëtuar kryesisht drejt këtyre dy vendeve përmes kontratave të punësimit për punëtorë 'mysafirë'. Kjo përputhet me hulumtimet, të cilat tregojnë se familjarët apo miqtë që jetojnë në një vend mund të tërheqin emigrim të mëtejshëm. Duke u ofruar informata emigrantëve potencialë për mënyrat e emigrimit dhe kushtet në vendet nikoqire në bazë të eksperiencës së tyre, si dhe duke i ndihmuar ata që të gjejnë punë dhe strehim para emigrimit, ata ulin koston e transaksione për emigrantët e rinj (Germeji and Swinnen, 2005). Kjo shndërrohet në nxitës për migrantët potencialë që ata të udhëtojnë në të njëjtin vend ku gjenden të afërmit apo miqtë e tyre. Një faktor tjetër që e nxit emigrimin në një vend mund të jetë niveli i remitancave që dërgohet nga emigrantët që jetojnë në atë vend. Në këtë rast, shumica e remitancave dërgohen nga Gjermania (40%) dhe Zvicra (20%). Këto mund të jenë përdorur për të financuar emigrimin e anëtarëve të tjerë të familjes.

Tabelala 2: Shpërndarja e emigrantëve sipas shteteve nikoqire

Shteti nikoqir	Përqindja e emigrantëve
Gjermania	39.4
Zvicra	23.2
Italia	7
Austria	6.7
Vendet skandinave	5.8
Mbretëria e Bashkuar	4.8
SHBA	3.5
Franca	2.1
Kanada	1.6
Vendet fqinje	3.7
Vendet e tjera	2.2

Anketa me familje e Riinvest-it, 2007

Vendet e tjera nikoqire të BE-së përfshijnë Austrinë (6.7%), Italinë (7%), Skandinavinë (5.8%), Mbretërinë e Bashkuar (4.8%) dhe Francën (2.1%). Një përq-

indje relativisht e vogël e emigrantëve jetojnë në shtetet fqinje, rreth 3.7%. Një përqindje e papërfillshme jeton në Shqipëri (0.1%), në Bosnjë e Herecgovinë (0.3%), në Slloveni (0.77%) dhe në Kroaci (1.6%). Disa nga këta mund të jenë migrantë qarkullues, të cilët bëjnë punë sezonale në këto shtete.

STATUSI LIGJOR NË VENDIN E BANIMIT

Sipas anketës me familje, shumica e të anketuarve kanë nënshtetësi të vendit nikoqir. 57%. Rreth një e treta e diasporës ka leje të përkohshme qëndrimi në vendin nikoqir për periudha 2-10 vjeçare. Nga këta, ata që punojnë me viza përbëjnë një përqindje relativisht të vogël, 11%.

Tabela 3: Statusi ligjor në vendet nikoqire

	Përqindja e emigrantëve
Nënshtetësi	57.13
Leje e përkohshme qëndrimi, 2-5 vjet	7.94
Leje e përkohshme qëndrimi, 5-10 vjet	18.94
Bashkim familjar	8.04
Vizë pune	3.36
Vizë studentore	0.41
Të tjera	4.18

Anketa me familje e Riinvest-it, 2007

Nëse shikojmë statusin ligjor të emigrantëve veçmas, sipas vendeve nikoqire, dalin rezultate interesante. Emigrantët në Gjermani dhe Zvicër, megjithëse përbëjnë pjesën më të madhe të emigrantëve, vetëm 58%, përkatësisht 46.2% nga këta, kanë nënshtetësi. Ndërsa, emigrantët në SHBA dhe Mbretëri të Bashkuar, të cilët përbëjnë një pjesë të vogël të diasporës, gati të gjithë kanë nënshtetësi, 88%, përkatësisht 65%. Nga emigrantët në vende skandinave, pjesa më e madhe e të cilëve jetojnë në Suedi, 86% kanë nënshtetësi të vendit nikoqir. Megjithëse vetëm 1% të emigrantëve jetojnë në Norvegji, ky vend është vendi me përqindje më të lartë të emigrantëve që kanë nënshtetësi, 90%.

PLANET PËR KTHIM

SR rezultatet e anketës tregojnë lidhje të forta mes emigrantëve dhe Kosovës. Rreth 76% e emigrantëve planifikojnë të kthehen në Kosovë, nga të cilët dy të tretat planifikon të kthehen pas pensionimit, dhe një e treta planifikon të kthehet para kësaj. Kthimi i emigrantëve ka më shumë të ngjarë të ndodhë pas pensionimit, pavarësisht nga statusi i tyre në vendet nikoqire.

Është pothuajse e sigurt që arsyeja kryesore për planet e emigrantëve për t'u kthyer janë lidhjet e forta familjare që mbizotërojnë në shoqërinë kosovare.

Duke marrë parasysh që shumica e tyre planifikojnë të kthehen pas pensionimit, potenciali i të kthyerve për të kontribuar, sidomos në aspekt të kapitalit human, është relativisht i vogël duke pasur parasysh që koha e mbetur për transfer të kapitalit human është relativisht e shkurtër.

KUSHTET EKONOMIKE TË EMIGRANTËVE

Punësimi

Gati dy të tretat e emigrantëve nuk kanë qenë të punësuar para se të lëshonin Kosovën. Për dallim nga kjo, 58% e emigrantëve janë aktualisht të punësuar në vendet nikoqire. Kjo fuqimisht sugjeron se emigrimi është shkaktuar në rradhë të parë nga arsyt ekonomike. Prandaj, kushtet ekonomike mund të kenë qenë në masë të madhë arsye për emigrim.

Tabela 4: Punësimi sipas vendit nikoqir

Shteti	Pjesa e emigrantëve që janë të punësuar (%)
Gjermania	68
Zvicra	68
Vendet skandinave	75
SHBA	60
Kanada	87.5
Kroacia	50
Sllovenia	62.5

Anketa me familje e Riinvest-it, 2007

A breakdown of Diaspora employment rates by host country is presented in Tabela Ndarja e normave të punësimit sipas vendit nikoqir është prezantuar në Tabelën 4. Kjo tregon disa ndryshime në krahasim me shpërndarjen e emigrantëve sipas vendit ku jetojnë. Normat e punësimit në Gjermani dhe Zvicër, 68%, janë më të ulta se normat e punësimit në Kanada, 87.5% dhe në vendet skandinave, 75%.

Normat e punësimit sipas gjinisë japin raport 1:1 mes të të punësuarve dhe të papunëve për femra, ndërsa për meshkuj ky raport është më i lartë në favor të punësimit, 7:2.

Pak mbi gjysma e diasporës është e punësuar në ndërtimtari dhe hotele/restorante, shih Tabelën 5. Këto janë dy nga sektorët më të zhvilluar në Kosovë. Pjesë relativisht të vogla të diasporës janë të punësuar në sektorët që mbeten prapa përse i përket zhvillimit të tyre në Kosovë, siç janë shëndetësia, arsimiti, dhe financat. Prandaj, përfitimet nga transferi i teknologjisë nga kthimi i diasporës kanë të ngjarë të jenë modeste.

Tabela 5: Punësimi sipas sektorit

Sektori	Pjesa e të punësuarve
Ndërtimtaria	38.6
Hotelet/ restorantet	13.0
Prodhimi	12.7
Bujqësia	5.3
Tregtia	5.3
Transporti dhe komunikimi	5.1
Shëndetësia dhe arsimi	4.7
Shërbimet publike	2.3
Sektori financiar (bankat, kompanitë e sigurimeve, etj.)	2.1
Administrimi publik	1.5
Minierat	1.3
Të tjera	8.1

Anketa me familje e Riinvest-it, 2007

Gati gjysma e meshkujve të diasporës (47.4%) janë të punësuar në ndërtimtari. Ndërsa, punësimi i femrave është më pak i koncentruar; sektorët dominantë janë hotelet dhe restorantet (23%), si dhe shëndetësia dhe arsimi (18%).

Tabela 6: Niveli i punësimit

Profesioni	Pjesëmarrja në numrin e përgjithshëm të të punësuarve (%)
Menaxher/mbikëqyrës	7.57
Administrator	0.9
Punëtor me kualifikime të ulta	82.16
Shitës	4.68
Të tjera	4.68

Anketa me familje e Riinvest-it, 2007

Të ardhurat

Sipas anketës së vizitorëve, 40.05% marrin mes €1,501 dhe €3,000 në muaj, 27.04% marrin mes €500 dhe €1500, dhe 20% marrin mes €3,001 dhe €5,000, shih Tabelën 7. Këto rezultate japin një mesatare të pagës mujore prej €1,700. Tabela 7: Pjesëmarrja e emigrantëve sipas intervaleve të të ardhurave mujore

Tabela 7: Share of emigrants by monthly income intervals

Shuma në Euro	Pjesëmarrja (%)
€500- 1500	27.04
€1501-3000	40.05
€3001-5000	20.35
€5001- 8000	8.80
Më shumë se €8000	2.93
Totali	100

Anketa me familje e Riinvest-it, 2007

NDIKIMI EKONOMIK AKTUAL DHE POTENCIAL I DIASPORËS

Matja e shumës totale dhe rrjedhjes së remitancave është shumë e vështirë. Ekzistojnë disa vlerësime të përafërta për numrin e kosovarëve që jetojnë jashtë vendit, mirëpo në këtë kategori demografike nuk ekzistojnë informata shtesë. Njëra prej qëllimeve të këtyre dy anketave, vizitor dhe familjar, ishte gjithashtu për të vlerësuar rrjedhën financiare të remitancave aktuale brenda Kosovës.

Sipas anketës familjare, 30 për qind e familjeve në Kosovë kanë së paku nga një anëtar duke jetuar në shtete të tjera. Struktura regjionale e emigrantëve tregon se ekzistojnë dy qendra nga të cilat njerëzit emigrojnë, nga Prizreni rreth 25.8 për qind dhe nga Prishtina rreth 23.6 për qind të emigrimit total. Këto dy qendra përcillen nga regjionet e tjera, si Mitrovica, Ferizaj, Peja, etj. Siç duket, struktura regjionale e emigrantëve nuk e përcjell në mënyrë të përpiktë strukturën regjionale të popullatës së Kosovës. Megjithatë, kjo strukturë jep indikacione në favor të regjioneve që kanë një prirje tradicionale drejt emigrimit, siç është Prizreni. Sipas të njëjtës logjikë, struktura regjionale e emigrantëve nuk është edhe krejtësisht e njëjtë me strukturën regjionale të atyre që dërgojnë remitanca. Prapëseparë, emigrantët nga Prizreni dërgojnë më shumë para (27.5 për qind të totalit) në shtëpitë e tyre në proporcion me ata nga Prishtina (24.6 për qind), Mitrovica (12.2 për qind), Ferizaj (11.4 për qind), e kështu më radhw. Megjithatë, përderisa Gjilani bën pjesë me nëntë për qind të emigracionit kosovar (pasuar nga Peja me 11 për qind), ata dërgojnë remitanca më shumë sesa emigrantët nga Peja. Përderisa emigrantët nga Gjilani përbëjnë rreth 9.4 për qind të totalit të atyre që dërgojnë remitanca, emigrantët nga Peja përbëjnë vetëm 8.7 për qind të totalit.

Sipas anketës së vizitorëve dhe anketës familjare, ekzistojnë disa mospërputhje në numrin e emigrantëve që dërgojnë remitanca. Sipas anketës së vizitorëve, vetëm 70 për qind dërgojnë remitanca (d.m.th. 18 për qind të mostrës), ndërsa anketa familjare tregon se gati 90 për qind e emigrantëve dërgojnë remitanca (shih Tabelën 8). Diferenca mund t'i atribuohet diferencave në madhësinë e mostrës dhe shpërndarjes së mostrës (duhet ta kemi parasysh se anketa e vizitorëve nuk përfshin migruesit ilegalw). Për më tepër, dallimi i rezultateve mund të jetë subjektiv: së pari, ata që dërgojnë remitanca dëshirojnë të thonë dhe të ekzagjerojnë zemërgjerësinë e tyre dhe pranuesit e remitancave mund të ndodhë që ata të paraqiten nevojtarë, ose nga ndonjë dëshirë për t'u ardhur keq të tjerëve, apo më tepër për t'iu shmangur zbulimit të të ardhurave.

Tabela 8: Përqindja e emigrantëve kosovarë që dërgojnë remitanca

	Anketa familjare	Anketa e vizitorëve
	Përqindja	Përqindja
Po	68.81	88.38
Jo	31.19	11.62
Nr. Total i respondentëve	100.00	100.00

Burimi: Anketa e vizitorëve dhe Anketa me familje (Riinvest, 2006 dhe 2007)

Shënim: Pyetjet pa përgjigje janë larguar nga tabela

Ekzistojnë dilema se a do të vazhdojë diaspora në të ardhmen që të kontribuojë me të njëjtin nivel të remitancave të familjet dhe farefisi i tyre që jetojnë në Kosovë. Rezultatet e hulumtimit sugjerojnë se gatishmëria e diasporës për të ndihmuar Kosovën nuk është aq e madhe sa ka qenë në periudhën e para luftës, mirëpo remitancat do të vazhdojnë edhe pse do të jenë në një masë më të vogël. Të intervistuarit në diasporë kanë deklaruar që të afërmit e tyre në Kosovë vazhdojnë të jenë brengë e tyre dhe për këtë arsye ata do të vazhdojnë që t'i mbështesin për aq kohë sa të jetë e nevojshme¹⁵. Kjo mund të konfirmohet, po ashtu, edhe ndërmjet remitancave që ju dërgohen atyre në mënyrë të vazhdueshme dhe të rregullt. Sipas Anketës së vizitorëve (dhjetor 2006) gati rreth 90 për qind të njerëzve nga diaspora dërgojnë para "rregullisht" apo "nganjëherë" të familjet e tyre në Kosovë, në krahasim me mbi 10 përqindëshin që nuk dërgojnë remitanca. Edhe një herë, duhet ta kemi parasysh që këto përqindje iu referohen vizitorëve të diasporës, e jo popullatës së diasporës në përgjithësi.

Kjo anketë tregon që 71.6% e të anketuarve dërgojnë nga 100 – 1,000 Euro në vit, përdërisa rreth 18% dërgojnë prej 1,000-3,000 euro. Shuma disi të njëjta janë nxjerr edhe nga Anketa Familjare e Riinvestit (2007), duke treguar që familjet që marrin remitanca, 66% të tyre marrin ndërmjet 100 dhe 1,000 euro në vit dhe 22% marrin ndërmjet 1,000 dhe 3,000 euro në vit. Mirëpo, prapë që të dy anketat tregojnë rezultate të ngjashme në frekuencën e remitancave të dërguara/marra nga diaspora/anëtarët familjarw në Kosovë (shih tabelën 9).

Kur janë pyetur lidhur me perceptimin e tyre në trendin e ardhshëm të remitancave, atëherë rreth gjysma e familjarëve që kanë dikë jashtë vendit besojnë se këto remitanca do të vazhdojnë të jenë të qëndrueshme apo të rriten, në kundërshtim me 24% prej atyre që thonë se ky trend do të pësojë rënie. Rezultatet e prezantuara mund të forcojnë dëshmitë në lidhjet e forta ekzistuese ndërmjet diasporës dhe vendit amë të tyre, si dhe vazhdimi i gatishmërisë së tyre për përkrahjen e familjeve të tyre.

15 Focus Groups' Discussions in Germany, Switzerland and Sweden (2007)

Tabela 9: Përqindja e atyre që dërgojnë remitanca

	Anketa familjare	Anketa e vizitorëve ¹⁾
	Përqindja	Përqindja
Një herë në muaj	31.87	30.65
Një herë në 3 muaj	32.97	35.06
Një herë në 6 muaj	20.15	22.38
Një herë në vit	15.02	11.91
Nr. total i të anketuarve	100.00	100.00

Burimi: Anketa e Vizitorëve dhe Anketa me familje (Riinvest, 2006 dhe 2007)

Shënim: Pyetjet pa përgjigje janë larguar nga tabela ¹⁾ Anketa e vizitorëve përfshin një kategori shtesë, d.m.th 'Të tjerët', që është larguar (21 prej 967 të të anketuarve kanë përzgjedhur këtë kategori)

Sa u përket shumave të atyre që dërgojnë remitanca, anketa jonë tregon një ndryshim të vogël të shpërndarjes. Përderisa përgjigjet në anketën familjare janë të koncentruara kryesisht në kategorinë "€100-500" (pothuajse 30% e të anketuarve) vetëm 16% e të anketuarve në anketë kanë deklaruar se ata dërgojnë remitanca në shumë prej 100 – 500 euro (shih tabelën 10 më poshtë). Shpërndarja në kategori prej 500 e deri në 3,000 euro, është shumë e ngjashme në të dy anketat, sidomos prej 1,000 e deri në 3,000 euro. Sipas anketës, një mospërputhje është e shënuar në kategorinë '4,000 – 9,000 euro' ku pothuajse 20 për qind dërgojnë remitanca brenda këtij kufiri, në krahasim me vetëm 12 për qind sipas anketës familjare. Megjithatë, duhet të theksohet se anketa familjare mbulon remitancat nga diaspora që vizitojnë Kosovën dhe ata që nuk e vizitojnë. Është e mundur që mesatarisht vizitorët kanë mundësi më të mëdha financiare dhe/apo kanë një përkushtim më të madh ndaj familjeve të tyre në krahasim me krejt diasporën kosovare. Nëse qëndron kjo, atëherë duhet të pritet që niveli mesatar i remitancave do të jetë më i lartë nga vizitorët sesa nga tërë diaspora.

Tabela 10: Shuma e remitancave të dhëna nga diaspora kosovare

	Anketa familjare	Anketa e vizitorëve ¹⁾	
	Në baza vjetore	Në baza vjetore	Në baza mujore
	Përqindja	Përqindja	Përqindja
100-500	28.17	16.47	66.19
500-1000	17.86	21.26	26.68
1000-2000	19.05	20.06	4.89
2000-3000	19.05	19.16	1.63
4000-9000	12.30	18.86	0.61
10000- 20000	3.57	4.19	-
Total respondents	100.00	100.00	100.00

Burimi: Anketa e Vizitorëve dhe Anketa me familje (Riinvest, 2006 dhe 2007)

Shënim: Pyetjet pa përgjigje janë larguar nga tabela ¹⁾ Anketa e vizitorëve përfshin një kategori shtesë, 'Të tjerët', që është larguar (në anketën familjare ekzis-

ton 1 i anketuar në këtë kategori, ndërsa në anketën e vizitorëve janë 6 të anketuar)

MATJA E REMITANCAVE DHE KONTRIBUTET E TJERA NGA DIASPORA

Siç e kemi argumentuar më herët, matja e nivelit të remitancave është shumë punë e vështirë. Duke u bazuar në të dhënat e anketës (anketës familjare dhe anketës së vizitorëve), si dhe informatave tjera shtesë të marra nga intervistat dhe nga burimet e tjera, ne vlerësojmë remitancat në para të gatshme, turizmi i diasporës, si dhe remitancat në mallra.

Për vitin 2007, vlerësojmë se remitancat totale në para të gatshme janë 170 milionë euro, remitancat e përgjithshme në mallra janë 22 milionë euro, si dhe 125 milionë Euro vlerësohet shuma e 'turizmit nga diaspora'. Megjithatë, totali i hyrjeve të remitancave në ekonominë e Kosovës nga diaspora, vlerësohet të jetë rreth 317 milionë euro në vitin 2007 (shih tabelën 11 për më shumë detaje).

Tabela 11: Vlerësimi i rrjedhjes së financave dhe mallrave nga diaspora: Kosova, 2007

Përshkrimi	
Nr. total i familjeve që marrin remitanca	73,500
Shuma mesatare e remitancave për familje (euro)	2,315
Shpenzimet mesatare për çdo vizitor	575
Remitancat në para të gatshme	170,000,000
Vetura	9,500,000
Veshëmbathje	7,000,000
Pajisje Elektrike	4,800,000
Mjekësi	660,000
Remitanca në mallra	22,000,000
Numri total i vizitorëve nga Diaspora	220,000
'Turizmi i Diasporës'	125,000,000
Remitancat e përgjithshme	317,000,000

Burimi: Anketa e Vizitorëve dhe Anketa me familje (Riinvest, 2006 dhe 2007).

Remitancat në mallra

Ne vlerësojmë që popullata e përgjithshme e Kosovës (d.m.th që jetojnë në Kosovë dhe jashtë vendit) është 2.5 milion. Sipas anketave tona, 13 përqind të Kosovarëve jetojnë jashtë vendit (numri i përgjithshëm i individëve në anketën familjare është 8,385 nga të cilët 1,056 janë duke jetuar jashtë vendit). Nëse aplikojmë të njëjtën përqindje për tërë popullatën, atëherë rezultoni se ne kemi përafërsisht rreth 315,000 Kosovar që jetojnë jashtë vendit. Në vijim, burime të ndryshme (Riinvesti dhe qendra të tjera hulumtuese) vlerësojnë se madhësia mesatare e një familje është 6.4 anëtarë. Duke u bazuar në shumën e përgjithshëm të popullatës, rezultoni se diku rreth 390,000 familje janë në Kosovë. Duke pasqyruar se në vitin 2004 sipas regjistrimit të tatimeve në pronë, Kosova ka pasur diku rreth 325,000 familje, prandaj rezultati se në Kosovë jetojnë rreth 390,000 familje mund të jetë pak i ekzagjeruar. Ne besojmë se mesatarja e këtyre dy shumave është më e besueshme, prandaj edhe e rrumbullakojmë numrin e familjeve në 350,000 familje në Kosovë.

RËNDËSIA KRITIKE E REMITANCAVE PËR FAMILJET KOSOVARE


Sipas vlerësimeve tona, remitancat në vitin 2007 llogariten të jenë 17 për qind të shpenzimeve familjare në Kosovë (parashikimet e FMN-së, shkurt 2007, tregojnë që konsumi familjar në Kosovë për vitin 2007 është 2,137 milionë euro). Me fjalë të tjera, pothuajse çdo e shtata euro, që është shpenzuar gjatë vitit 2007, ka rrjedhur nga remitancat. Këto kalkulime ilustrjnë rëndësinë e remitancave për të plotësuar nevojat familjare.

Figura 13 bashkon rezultatet nga anketa familjare dhe të dhënat për gjashtë vendet e EAQ-VE¹⁶, shumica e remitancave janë të përkushtuara për nevojat themelore të konsumimit, d.m.th. ushqim dhe veshëmbathje. Megjithatë, në Kosovë mbi 45 për qind të remitancave shpenzohen për konsumimin e këtyre mallrave, ndërsa në shtetet e tjera të EAQ-VE, mesatarja është rreth 30 për qind¹⁷. Ky dallim është sugjerues i nivelit të lartë të varësisë së familjeve kosovare në remitancat, për të plotësuar nevojat e tyre bazike. Dallim tjetër i strukturës së shpenzimeve është se, përafërsisht rreth një e shtata e këtyre fondëve në shtetet e tjera të EAQ-VE janë të përkushtuara për riparime shtëpiake, përballë rreth një të pestës në Kosovë. Kjo mundet që pjesërisht të reflektojë riparimet e vazhdueshme nga dëmet e luftës së vitit 1999. Pjesa e remitancave që shpenzohet në arsimim ishte pothuajse e ngjashme në Kosovë dhe në shtetet e tjera të EAQ-VE.

16 Këto shtete janë: Bosnjë e Herzegovina, Bullgaria, Gjeorgjia, Republika e Kyrqyzit, Rumania dhe Taxhikistani.

17 Ne duhet që të shënojmë se këto ndryshime mund të jenë si atribut i faktit se struktura e shpenzimeve nga remitancat në rastin e shteteve të EAQ-VE thjeshtësohet edhe më shumë në proporcion me Kosovën (në vijim kemi disa prej kategorive që janë të përfshira në rastin e shteteve të EAQ-VE, mirëpo në rastin e Kosovës këto kategori janë harruar dhe nuk janë futur: kursimet, blerjet e tokës/veturës, etj.).

Figura 13: Krahasimi i strukturës së shpenzimeve nga Rezultatet për shtetet e EAQ-VE janë të bazuara në anketat me migrantët e kthyer.



Burimi: Banka Botërore (2007) dhe anketa e Riinvestit me emigrantë (2007)

Shënim: Gjashtë shtete të EAQ-VE: BeH, Bullgaria, Gjeorgjia, Republika e Kyr-gyzit, Rumania, dhe Taxhikistani

Në shtetet e tjera të EAQ-VE, 4 për qind të remitancave shfrytëzohen për investime të biznesit, përballë tre për qind në Kosovë. Ky dallim është i kuptueshëm, për arsye se kushtet për të investuar në Kosovë nuk janë shumë të favorshme.

Sipas anketës familjare, një destinim tjetër i rëndësishëm i remitancave është edhe për qëllime mjekësore. Mbi 17 për qind të remitancave shpenzohen nga familjarët për furnizime mjekësore dhe shërbime (përballë rreth 7 për qind në shtetet e EAQ-VE). Për qindja e madhe e dedikuar për furnizime mjekësore dhe shërbime reflekton mosekzistimin e mekanizmave të sigurimit shëndetësor. Për të përmbledhur, mund të themi se pa dyshim efektet e remitancave dhe të turizmit nga diaspora janë të rëndësishme për ekonominë e Kosovës dhe për mirëqenien e familjeve marrëse të remitancave.

Siç është theksuar më lart, efektet pozitive në ekonomi zvogëlohen nga pjesa e madhe e mallrave të importuara, që blihen me remitanca (për shembull, pothuajse të gjitha barnat janë të importuara, po ashtu edhe një pjesë e madhe e materialit ndërtimor importohet).

REMITANCAT DHE ZVOGËLIMI I VARFËRISË


Varfëria ende paraqet një prej problemeve kryesore me të cilat ballafaqohet popullata e Kosovës. Përqindja e popullatës që jeton në varfëri është rritur nga 37% në vitin 2002, në 44% në vitin 2003-2004, përderisa përqindja e popullatës që jeton në varfëri të skajshme ka rënë nga 15.2% në 14%, gjatë po të njëjtës periudhë (ESK, 2005). Sipas profilit të varfërisë, shihet se grupet më të ndjeshme përfshijnë familje me numër të madh të fëmijëve (tre ose më shumë), personat me nevoja të veçanta ose të papunët si dhe familjet me kryefamiljarë femra (Banka Botërore, 2005).

Teoria nuk e ka dhënë një përgjigje definitive mbi ndikimin e migracionit në varfëri. Një pjesë e autorëve shprehen se migracioni është një prej përgjigjeve për t'i ikur papunësisë dhe varfërisë. Prandaj, migracioni thuhet se mund të zvogëlojë varfërinë. Pjesa tjetër e autorëve argumentojnë se nga migracioni, përmes ndikimit të remitancave, përfitojnë vetëm familjet, të cilat marrin remitanca. Duke marrë parasysh që migracioni kushton, ndodh që migracioni të koncentrohet më shumë në mesin e familjeve, të cilat kanë një standard më të lartë të jetesës. Pasi që këto familje, të cilat veç janë më të pasura përfitojnë nga migracioni, të ardhurat mesatare rriten, mirëpo në dëm të pabarazisë në të ardhura brendapërbrenda popullatës.

Për të fituar një pasqyrë të ndikimit të migracionit në varfëri dhe pabarazi në të ardhura në Kosovë, efekti i remitancave në të ardhurat e përgjithshme të familjeve është analizuar duke u shërbyer me anketën me familje.

Duke mos marrë parasysh remitancat, të ardhurat mesatare të raportuara nga familjet arrijnë në €432. Nëse merren parasysh remitancat, kjo shifër rritet në €518. Një ndikim i tillë mbështetet edhe në faktin që remitancat përbëjnë rreth 16-17% të të ardhurave mujore të familjeve. Si rezultat, mund të thuhet se remitancat ndikojnë në përmirësimin e standardit jetësor të familjeve që marrin remitanca.

Për të kuptuar aspektet në të cilat remitancat ndikojnë në situatën socio-ekonomike të familjeve që marrin remitanca dhe ndikimin e tyre në zhvillimin e vendit amë, është analizuar mënyra e shpenzimit të remitancave. Rezultatet nga anketa me familje tregojnë se 45% e remitancave shkojnë në konsum privat. Pjesa e mbetur është e shpërndarë në mënyrë proporcionale në ndërtim të shtëpive (19%), nevoja shëndetësore (17%), dhe edukim (16%). Një përqindje relativisht e vogël (3%) investohet në aktivitete ndërmarrëse. Si përfundim, remitancat përdoren për aktivitete ndërmarrëse dhe kështu për krijimin e vendeve të reja të punës, ndihmojnë në zbutje të konsumit privat dhe përmirësim të kushteve të jetesës, si dhe ndihmojnë në tejkalimin e kufizimeve financiare për investime në edukim dhe shëndetësi, të cilat, më pas, reflektohen në zbutje të varfërisë për fituesit.

Figura 4: Strukturat e shpenzimit të remitancave

Anketa me familje e Riinvest-it, 2007

Për të analizuar ndikimin e remitancave në pabarazi në të ardhura, Skeldon (2003) sugjeron që të shikohet shpërndarja e remitancave sipas kuintaleve të popullatës, të shprehura përmes intervaleve të të ardhurave. Aplikimi i kësaj metode në të dhënat e anketës me familjet, siç shihet në tabelën më poshtë, tregon se remitancat, të shprehura përmes përqindjes së familjeve që marrin remitanca sipas niveleve të të ardhurave, është shpërndarë proporcionalisht në mes të familjeve me nivele të ndryshme të të ardhurave, d.m.th. popullatës. Një shpërndarje e tillë reflekton ndikimin e remitancave në zvogëlimin e pabarazisë në të ardhura në rastin e Kosovës.

Tabela 13: Përqindja e remitancave totale të pranuar sipas intervalit të të ardhurave

Niveli i të ardhurave (në euro)	< 100	100-200	201-300	301-500	501-1000	1001-1500	>1501-2000
Përqindja e remitancave të pranuar	17.66	18.35	24.73	24.74	7.38	3.43	3.7

Anketa me familje e Riinvest-it, 2007

Po ashtu, kur analizohet shpërndarja e remitancave totale sipas intervalit të të ardhurave të familjes (shih tabelën 13), mund të konkludojmë se pjesa dërrmuese e remitancave pranohen nga familjet, të cilat jetojnë me më pak se €100 për muaj, 17.66%, përderisa përafërsisht 63.68% e remitancave pranohet nga familjet që jetojnë me €101-500 për muaj, d.m.th. nga familjet që kanë një standard jetësor mesatar.¹⁸

Si përfundim, sipas analizës statistikore, migracioni ka ndihmuar në përmirësimin e situatës socio-ekonomike të familjeve kosovare dhe ka ndikuar në zbutjen e varfërisë dhe pabarazisë në të ardhura.

INVESTIMET E DIASPORËS, SITUATA AKTUALE DHE POTENCIALET

Prona, Bizneset dhe Asetet tjera në Kosovë

Diaspora mund të kontribuojë në vendin amë përmes remitancave për konsum ose investimeve nga familjet e tyre dhe përmes investimeve direkte të diasporës në vendin amë. Në Kosovë, efekti i fundit është analizuar përmes investimeve direkte në biznese dhe përmes pjesëmarrjes së tyre në procesin e privatizimit, ose si investitorë individual ose si të bashkuar.

Të dhënat nga hulumtimi i vizitorëve (shiko tabelën 15) tregojnë se një e katërta e respondentëve kanë investuar në biznes ose infrastrukturë në Kosovë.

Tabela 14: A keni investuar në biznes ose infrastrukturë në Kosovë?

	Përqindja
Kam investuar	23.6
Nuk kam investuar	69.6
Do te investoje ne te ardhmen	6.8
Totali	100.0

Burimi: Anketa me vizitore, 2007

Investimet e Diasporës janë të ndara në: 15% kanë investuar në biznes në Kosovë, 79% kanë investuar në ndërtesa biznesi dhe 6% kanë investuar në ndërtim të shtëpive. Rreth 86% e atyre që kanë investuar u kanë besuar të afërmeve të tyre për të menaxhuar në Kosovë, 7% kanë deklaruar se menaxhojnë bizneset direkt dhe udhëtojnë shpesh për në Kosovë, 3% e tyre punësojnë jo të afërmit ose kanë bord menaxhues për drejtimin e bizneseve të tyre, dhe pjesa tjetër tregon mënyra tjera të menaxhimit të bizneseve të tyre. Kjo ndarje reflekton dominimin e kulturës së bizneseve familjare në Kosovë.

¹⁸ Sic shihet më lartë, të ardhurat mesatare të familjes pa remitancat janë përafërsisht €432.

Emigrantët dhe Ndërmarrësia

Siç është paraqitur edhe më lartë, 15% e investimeve të diasporës shkon në aktivitetet biznesore. Kur janë pyetur për lidhjen në mes të bizneseve të tyre private dhe profesionit të fituar në vendin nikoqir, anketa me familjet tregon se në 44% të rasteve ka lidhje në mes të këtyre dy elementeve, kurse në 56% të rasteve janë mohuar lidhjet. Duke pasur parasysh që ekziston një pjesë e madhe e emigrantëve të cilët e kanë konfirmuar këtë lidhje, ky fakt mund të tregojë se ka transfer të kapitalit human përveç remitançave që dërgohen prej vendit nikoqir në Kosovë përmes investimeve të emigrantëve në bizneset private.

Sipas anketës së vizitorëve, 43% kanë raportuar të ardhura biznesore mujore prej 1,000 eurosh ose më pak, 34% e tyre kanë raportuar të ardhura në mes të 1,001 euro dhe 3,000 euro, pjesa tjetër fitojnë më shumë se 3,000 euro. Nëse konsiderojmë kapacitetet e limituara të Kosovës për të investuar dhe krijuar vende të reja të punës, investimet nga emigrantet janë me shumë se të mirëseardhura për të përmirësuar këtë situatë. Si rrjedhim, investimet e tyre duhet të konsiderohen si kontribut i madh për ekonominë e Kosovës. Sidoqoftë, siç është argumentuar edhe më lartë, duke pasur parasysh që sektori i tregtisë dhe i hotelerisë janë në mesin e sektorëve më të zhvilluar në ekonominë e Kosovës, investimet e tyre në sektorët tjerë do të mund të kishin përfitime marginale më të larta. Kështu që, institucionet e Kosovës në kooperim me asociacionet e bizneseve duhet të hartojnë strategji për investime dhe programe dhe të prezantojnë ato strategji para emigrantëve për investime potenciale. Në këtë aspekt, është shumë e rëndësishme edhe për institucionet e Kosovës edhe për asociacionet e bizneseve të përpiqen të krijojnë mekanizma me efektiv të komunikimit dhe bashkëpunimit me qëllim të shfrytëzimit sa më të mirë të potencialit të emigrantëve.

Kontributet e ardhshme të emigrantëve drejt ekonomisë së Kosovës / Planet për investime në Kosovë

Sa i përket planeve të emigrantëve për investime të ardhshme në Kosovë, vetëm një pjesë e vogël, rreth 11%, kanë konfirmuar që janë dike planifikuar të investojnë në Kosovë (Anketa me Familje, 2007). Ata janë kryesisht të interesuar në prodhim, 45%, çka do të jetë përfituese në përmirësimin e dis-bilancit në treg në mes të sektorit të prodhimit dhe shërbimeve. Është me rëndësi të përmendim që 30% e emigrantëve planifikojnë të investojnë në patundshmëri për biznes ose qëllime private. Planet për investime në patundshmëri për qëllime private arsyetohen sepse edhe tetë vite pas luftës në Kosovë ende ka familje me strehim të përkohshëm ose pa strehim fare.

Tabela 15: Arsyet për te mos planifikuar për te investuar ne Kosovë

Arsyet për te mos investuar	Përqindja
1. Nuk kam qene i informuar nga institucionet e Kosovës lidhur me kushtet për biznes	30.5
2. Politikat fiskale te pafavorshme	18.6
3. Korrupsioni	26.0
4. Burokracia	2.8
5. Te tjera	22.1
	100.0

Anketa me familje e Riinvest-it, 2007

Duke marrë parasysh qe një pjesë e madhe e emigranteve mohojnë te kenë plane për investime, është shumë me rëndësi te analizohen arsyet lidhur me këtë. Sipas anketës me familje të vitit 2007, arsyet kryesore për të mos planifikuar investime përfshijnë mungesën e informacioneve nga ana e institucioneve rreth mundësive te investimit (30.5%), korrupsioni (26%) dhe politikat e pafavorshme fiskale (18.6%). Lidhur me këtë, të pyetur rreth perceptimeve te tyre për mjedisin biznesor ne Kosovë rreth 28% e vizitorëve nga Diaspora tregojnë se ata nuk janë të informuar fare; gjysma e vizitorëve theksojnë se mjedisi biznesor nuk është i favorshëm për investime, përderisa pjesa tjetër e konsiderojnë Kosovën si një mjedis te favorshëm për biznes dhe investime¹⁹. Siç është argumentuar edhe me lartë, institucionet e Kosovës duhet te marrin ne konsideratë këtë si thirrje për vëmendje. Ne këtë aspekt, ata duhet te iniciojnë kampanja për informim te emigrantëve lidhur me mundësitë e investimit ne Kosovë. Për me tepër, ata duhet gjithashtu te informojnë emigrantët rreth agjencive te ndryshme te qeverisë dhe asociacioneve te biznesit në të cilat mund të adresojnë planet e tyre për investime dhe gjithashtu te këshillohen rreth mundësive te investimit dhe çështjeve tjera me rëndësi. Është me rëndësi qe qeveria te përmirësojë efektivitetin e trupave ekzistues relevant për adresimin e nevojave dhe kërkesave te investitorëve potencial nga Diaspora.

Pasi që kemi analizuar aktivitetet biznesore dhe ndërmarrëse të Diasporës në Kosovë në vazhdim do te diskutojmë investimet e Diasporës ne procesin e privatizimit.

Diaspora dhe Privatizimi

Sipas diskutimeve me personelin e AKM-së (Agjencia Kosovare e Mirëbesimit) është vlerësuar se përafërsisht 10% e investimeve të përgjithshme në procesin e privatizimit në Kosovë janë kontribut i Diasporës Kosovare²⁰. Ky kontribut

¹⁹ Shih intervistën me Z. Agim Kalenderi, një afarist i sukseshëm Kosovar në Bruksel, (Aneksi 2).

²⁰ Llogaritje e përafërt dhe me shumë gjasë të jetë e nënvlerësuar ngase e vështirë të veçohet saktë kontributi i Diasporës në këtë proces.

përfshin edhe investimet e ndërmarrjeve jashtë në pronë të Diasporës Kosovare. Fatkeqësisht, nuk ka të dhëna në dispozicion lidhur me formën e kontributeve nga Diaspora e ndarë në teknologji dhe transfer të shkathtësive. Për të fituar ide rreth natyrës së investimeve të Diasporës në Kosovë, në kemi intervistuar oficerët në tri kompanitë me të mëdha të privatizuara nga anëtarët e Diasporës. Një përshkrim i detajzuar i këtyre rasteve studimore është i paraqitur në Aneksin 2. Në këtë sesion në paraqesim përfundimet kryesore. Investitorët nga diaspora shohin veprimet e tyre si mbështetje ndaj krijimit të vendeve të punës dhe përmirësimit të kushteve për ata që veçse janë të punësuar. Në frymën e proverbës “ta mësosh njeriun të kapë peshk”, kjo ishte e parë si formë më e preferueshme sesa dhënia e remitancave për të mbështetur direkt shpenzimet e familjeve. Për të siguruar investimet e tyre dhe për të asistuar punëtorët, investitorët nga Diaspora kanë vënë theksin në transferin e teknologjive nga ekonomitë më të zhvilluara. Për shembull, ata kanë financuar kurse trajnimi për punëtorët e tyre, kryesisht jashtë Kosovës. Përmes këtyre përpjekjeve, si dhe përmes importimit të inputeve me kualitet të lartë, ata besojnë që kualiteti i produkteve të tyre është përmirësuar.

Dy nga tri kompanitë e përzgjedhura eksportojnë produktet e tyre, njëra prej të cilave është duke prodhuar posaçërisht për eksport. Kjo është posaçërisht përfituese për ekonominë e Kosovës, kur marrim parasysh gjendjen aktuale të bilancit tregtar. Një ndryshim pozitiv shumë i rëndësishëm në këto kompani të privatizuara, i theksuar nga përfaqësuesit e tyre, është përmirësimi i etikës së punës dhe qasja me moderne ndaj biznesit.

Gjithashtu me interes ka qenë eksplorimi i faktorëve të cilët limitojnë investimet dhe zhvillimin në Kosovë. Faktori më së shpeshti i theksuar ka qenë statusi i pazgjidhur i Kosovës. Në radhë për nga rëndësia ishte “konkurrenca jolojale”. Ekziston një perceptim që mungesa e kontrollit, veçanërisht me respekt ndaj doganave, u jep importuesve përparësi të padrejta kundrejt atyre që përpunin të prodhojnë brenda Kosovës. Në këtë aspekt, pronari i fabrikës së përpunimit të peshkut theksoi: “Në nuk kërkojmë që qeveria të ndalojë konkurrencën nga jashtë mirëpo në kërkojmë që peshku i importuar të jetë subjekt i inspektimit sanitar dhe të inspektohet në mënyrë të përshtatshme nga doganat. Në këtë biznes problemi kryesor konsiderohet të jetë mungesa e inspektimit ndaj peshkut të importuar dhe korrupsioni me vjedhje, i cili ul çmimin e shitjes për peshkun dhe i ve në disavantazh prodhuesit vendorë.” Mungesa e personelit të kualifikuar është gjithashtu e listuar si pengese e zhvillimit të biznesit.

Në përgjithësi, rezultatet nga rastet studimore tregojnë nevojën për mbështetje me të fuqishme për investitorët nga Diaspora. Duhet të jetë prioritet i qeverisë krijimi i mjedisit biznesor i cili funksionon mirë.

ASPEKTET INSTITUCIONALE DHE LIDHJET ME DHE BRENDA DIASPORËS

LIDHJET ME FAMILJET

Duke reflektuar lidhjet e forta me familjet e tyre, 84% e të anketuarve në anketën me vizitorë tregojnë se komunikojnë me miqtë dhe të afërmit e tyre në Kosovë "shumë shpesh" ose "rregullisht". Kjo është në përputhje me Anketën me Familje në të cilën 80% e të anketuarve të cilët kanë anëtarë të familjes jashtë theksuan se komunikojnë me ta "çdo dite" ose "një herë në javë".

KOMUNIKIMI DHE MBËSHTETJA NGA AUTORITETET KOSOVARE

Hulumtimi nxori në pah moskënaqësi të konsiderueshme dhe kritika të Diasporës ndaj institucioneve Kosovare. Ekziston një bindje e përgjithshme që nevojat dhe kërkesat e Diasporës janë të injoruar në masë të madhe nga qeveria, bile edhe nga popullata, shiko kutinë 2. Ekziston gjithashtu një masë e madhe e pakënaqësisë me situatën e përgjithshme në Kosovë. Pjesëmarrësit në fokus grupe të ndryshme, të organizuara në disa vende të Evropës dhe në SHBA, kanë qenë posaçërisht të zëshëm rreth injorimit nga ana e Institucioneve Kosovare. Sipas anëtarëve të fokus grupeve, Institucionet Kosovare dhe qytetarët i kanë bërë njerëzit e Diasporës të ndihen si të "huaj" në vendin e tyre të lindjes.

Rezultatet e hulumtimit tregojnë se Diaspora vazhdon të jetë shumë e interesuar në situatën socio-ekonomike të Kosovës. Gjysma e diasporës tregojnë se janë mirë të informuar lidhur me situatën socio-ekonomike në Kosovë, 45% tregojnë se janë të informuar "deri në një masë" ose "pak të informuar", dhe 1.8% deklarojnë se ata "nuk janë fare" të informuar. Burimet kryesore të informimit të diasporës janë programet televizive për Kosovën dhe lajmet nga të afërmit nga Kosova. Burim tjetër shumë i rëndësishëm i informacionit është edhe interneti.

Përderisa diaspora është shumë e interesuar në marrjen e informacioneve rreth zhvillimeve në Kosovë, autoritetet kosovare dhe media kushtojnë shumë pak hapësirë për zhvillimet brenda Diasporës. Në takimet me fokus grupe, disa prej tyre kanë shfaqur pakënaqësitë me këtë situatë. Ata do të dëshironin të mbulohehin me shume nga media Kosovare lidhur me jetën, brengat, dhe arritjet e Diasporës.

KUTIA 2. DIASPORA DHE PAKËNAQËSITË E SAJ

"Tetë vite pas luftës, askush nuk e përmend ose jep lëvdatë për Diasporën rreth asaj që kanë bërë ata për Kosovën gjatë viteve 90' ... Aktualisht, askush nuk mendon për ne. Ne jemi të huaj në Gjermani dhe të huaj në Kosovë". Një pensioner i cili jeton në Gjermani.

"Njerëzit në Kosovë kanë filluar të na izolojnë, në sensin se na konsiderojnë në si të jemi të huaj në Kosovë ... Dëgjojmë njerëzit të thonë: nuk mund të marrim frymë nga ata që vijnë prej jashtë (Diaspora) gjatë pushimeve. Me këtë, ata na klasifikojnë si të huaj kur ne vijmë në shtëpitë tona apo në familjet tona". Një kryefamiljar i cili jeton në Londër.

"Ka mungesë të ngjarjeve kulturore këtu në Diasporë. Ka vetëm mbrëmje muzikore me këngëtare të cilët vijnë nga Kosova, të cilët në shumicën e rasteve ofrojnë vlera anti-kulturore". Një kryefamiljar i cili jeton në Zvicër.

"Ne kemi shpenzuar 10-12 vite duke e ndihmuar Kosovën, tani është koha të bëjmë diçka për vetveten". Një kryefamiljar i cili jeton në Suedi.

"Televizionet kosovare duhet të vijnë të vizitojnë Diasporën, ... Ato duhet të vijnë të takohen me biznesmen të suksesshëm dhe me rininë këtu, me qellim që të jenë të informuar rreth jetës dhe kushteve në të cilat jetojmë". Një i ri i cili jeton në Gjermani.

PROBLEMET

Njëra ndër fushat kryesore të pakënaqësive të Diasporës lidhet me problemet rreth marrjes së dokumenteve të udhëtimit dhe të drejtës për të votuar, shiko tabelën 18. Është fyerje e konsiderueshme kërkesa për të ri-aplikuar për dokumente çdo dy vite. Kjo është një kërkesë e kushtueshme dhe, për shumicën e tyre, kërkesë fyese. Veç kësaj, diaspora do të dëshironte programe edukimi shtese për fëmijët e tyre kur kthehen në vizite në Kosovë. Ata gjithashtu do të mirëpritnin ngjarjet kulturore të dizajnuara në atë mënyrë që të përfshinin edhe anëtarët e diasporës. Në të gjitha këto aspekte, jo-efektiviteti dhe sjellja e varfër e administratës është e fajësuar. Në të vërtetë, hulumtimi i Institutit Riinvest me Diasporën (Dhjetor 2006) tregon se dy të tretat e konsiderojnë administratën si problemin kryesor.

Dokumentet më të shpeshta që Diaspora i shfrytëzon për të udhëtuar në dhe nga Kosova janë dokumentet e vendit nikoqir (38.2%), dokumentet e Kosovës/UNMIK-ut (24.2%) dhe dokumentet e Jugosllavisë (37.3%).

Tabela 16: Problemet me te cilat përballet Diaspora nga Institucionet Kosovare

	Prob- lem shume i madh	Prob- lem serioz	Prob- lem	Prob- lem i parëndë- sishëm	Nuk është prob- lem	Ref	Total
Lëshimi i do- kumenteve	31.4	17.6	14.5	11.8	24.0	0.6	100.0
Edukimi shtese i fëmijëve	11.8	19.0	21.7	14.7	24.5	8.3	100.0
Qasja e In- stitucioneve te Kosovës kundrejt jush	30.5	19.3	18.4	14.4	16.8	0.5	100.0

Anketa me vizitorë e Riinvest-it, 2006

Masat administrative për të adresuar brengat e diasporës

In response to Diaspora's dissatisfaction with inefficient and time consuming Si përgjigje ndaj pakënaqësisë së diasporës me procedurat burokratike dhe të kushtueshme në kohë, Ministria e Brendshme e Kosovës, në bashkëpunim me Zyrën Kryesore të Regjistrimit të UNMIK-ut, në qershor 2007, ka zbatuar procedura të përsheptuara për prodhimin e dokumenteve të udhëtimit gjatë qershorit, korrikut dhe gushtit, për kosovarët që jetojnë jashtë. Në kuadër të kësaj nisme, kosovarëve që jetojnë jashtë vendit u janë dërguar zarfa të shënuar në mënyrë të posaçme, që tregojnë se aplikuesi është nga diaspora. Dokumentet e dërguara në këta zarfa prioritarë përpunohen shpejt, brenda 7 ose 5 ditëve pune. Për aplikantët që i mbushin 16 vjet, koha për marrjen e dokumentit të identifikimit dhe atij të udhëtimit është 10 ditë pune (5 ditë për secilën). Sipas këtij programi, Ministria, po ashtu, ka vënë në dispozicion persona kontaktues, të cilët punojnë me aplikantët. Përveç kësaj, puna e qendrave komunale të regjistrimit civil dhe Departamentit për Prodhimin e Dokumenteve të Udhëtimit do të mbikëqyren nga grupi i monitorimit i kësaj ministrie²¹.

Për të adresuar brengat e diasporës në lidhje me arsimim, në vitin 2007, Departamenti për Çështje Jorezidente i Ministrisë së Kulturës, Sportit dhe Çështjeve Jorezidente, ka filluar organizimin e ngjarjeve kulturore që i dedikohen diasporës.

21 Intervista me z. Eqrem Haziri, Drejtor i Departamentit për Regjistrimin Civil, Ministria e Punëve të Brendshme

Sipas zyrtarëve të Departamentit për Çështje Jorezidente, duke filluar nga viti 2008, kremtimi i "Ditës së emigrantëve kosovarë" do të zgjerohet në një javë të plotë dhe do të quhet "Ditët e emigrantëve kosovarë." Gjatë kësaj jave do të ketë ngjarje të shumta kulturore si dhe aktivitete sportive, takime të artistëve dhe valle popullore. Përveç këtyre, gjithashtu është një konferencë për investimet e diasporës në Kosovë.

Për të përmirësuar komunikimin me diasporën dhe për të zvogëluar barrën në lidhje me regjistrim dhe me dokumentet e tjera, Departamenti për Çështje Jorezidente do të hapë një faqe interneti për diasporën. Kjo në veçanti do të mundësojë regjistrimin e studentëve dhe ekspertëve që jetojnë jashtë, duke i ofruar qeverisë informim më të mirë për këta persona. Gjithashtu, ky Departament do të botojë një broshurë informatash, me interes për diasporën, të cilën do t'ua shpërndajë anëtarëve të diasporës që hyjnë në Kosovë. Për më tepër, në të ardhmen e afërt, një program i posaçëm në Televizionin e Kosovës planifikohet t'i dedikohet diasporës²².

Zyrtarët kosovarë të intervistuar gjatë këtij hulumtimi, kanë shprehur përkushtimin e tyre për të bërë më shumë për diasporën. Megjithatë, ata kanë deklaruar se janë të kufizuar për nga buxheti.

ARSIMI

Arsimi plotësues në diasporë ishte i organizuar mjaft mirë gjatë viteve të '90-ta dhe para viteve të '90-ta. Ai ishte organizuar me përkrahjen e institucioneve të Kosovës. Tani nuk ndodh kështu. Gjatë diskutimeve në grupe të fokusuar, kjo çështje vjen si një nga brengat kryesore. Kjo nuk është befasuese, pasi që numri i emigrantëve që jetojnë me familjet e tyre dhe me fëmijë është ngritur²³. Pas vitit 1999, arsimimi i të rinjve në gjuhë amëtare, histori, kulturë dhe art kombëtar, ka mbetur çështje private e emigrantëve. (Shih diskutimet me grupe të fokusuar me punëtorë në Bruksel dhe intervistën me një mësuese në kutinë e mëposhtme). Anketa me vizitorë gjithashtu tregon se 56% e të anketuarve kanë fëmijë që jetojnë në vendet nikoqire, por vetëm 1/3 e tyre merr arsim plotësues.

Për të pasur informata më të mira për efektivitetin e arsimit plotësues, disa pyetje janë bërë për njohurinë e gjuhës amëtare të fëmijëve të emigrantëve. Siç shihet në tabelën e mëposhtme, pjesa më e madhe e të anketuarve, 61.3%, mendojnë që fëmijët e tyre e kuptojnë dhe e flasin gjuhën amëtare shumë mirë. Mund të vijmë në përfundim se fëmijët e emigrantëve mësojnë gjuhën amëtare nga prindërit e tyre dhe nga televizioni. Mirëpo, ata nuk e mësojnë gjuhën përmes ndonjë mekanizmi insitucional. Për më tepër, rezultatet e anketës tregojnë që për më shumë se 70% të emigrantëve, arsimi plotësues në gjuhën shqipe për fëmijë konsiderohet si problem i rëndësishëm.

22 Intervistë me z. Naim Dedushaj, drejtor i Departamentit për Çështje Jorezidente, Ministria e Kulturës, Rinisë, Sportit dhe Çështjeve Jorezidente

23 Pothuajse 68 % e të anketuarve janë deklaruar se jetojnë me familje në vendet ku kanë emigruar (Anketa e Riinvestit me vizitorë, 2007)

KUTIA 3: MËSUESJA

Në mesin e diasporës në Bruksel kemi takuar një mësuese shumë entuziaste dhe punëtore. Ajo mëson 53 nxënës në këto lëndë: gjuhë shqipe, histori, gjeografi dhe art. Këto kurse janë të financuara nga prindërit. Ajo ankohet se mësimi në gjuhë amtare nuk është siç ka qenë. Para dhe gjatë viteve të '90-ta, në Belgjikë ka pasur rreth 40 mësues. Tani ky numër është vetëm 7-10. Nuk ka bashkëpunim me Ministrinë në Kosovë apo në Shqipëri. Një faktor i rëndësishëm po bëhen vizitat e rregullta në shtëpi gjatë pushimeve verore, por prapëseprapë ata kanë nevojë për kurse në gjuhën shqipe, të cilave nuk është duke iu dhënë rëndësi (Intervistë me znj. Nuriye Rama. Bruksel, korrik 2007)

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë është në proces të ndërtimit të programeve dhe aktiviteteve për këtë çështje. Problemi është që nuk ka vijë buxhetore që u dedikohet mbështetjes së këtyre aktiviteteve. Pjesëmarrësit në diskutimet e grupeve të fokusuara, e konsiderojnë të përshtatshëm organizimin e shkollave verore dhe këmbimin e studentëve në mes universiteteve të Kosovës dhe universiteteve të tjera, ku janë të koncentruar studentët nga Kosova.

ANGAZHIMI NË ZHVILLIMIN E QEVERISJES NË KOSOVË

Pjesa më e madhe e njerëzve të diasporës mendojnë që organizimi i tyre aktual në vendet nikoqire është më pak i kënaqshëm se në periudhën e paraluftës, shih Tabelën 19. Problemi kryesor është se individët janë të ndarë në baza partiake. Prandaj, ndarja politike brenda Kosovës pengon përpjekjet e diasporës për të komunikuar dhe punuar ndërmejt veti. 'Depolitizimi i organizimit të diasporës shihet si parakusht për organizim më të mirë në të ardhmen²⁴. Në përputhje me pakënaqësinë e tyre me strukturën aktuale organizative, mbi gjysma e të anketuarve (52.8%) kanë deklaruar se nuk janë pjesëtarë të ndonjë asociacioni në vendet nikoqire, si p.sh. parti politike, klube kosovare dhe asociacione kulturore dhe sportive. Për 54.0% të të anketuarve nga diaspora, mënyra e duhur për organizim dhe angazhim më të mirë të diasporës do të ishte përmes bashkëpunimit më të mirë ndërmjet klubeve të diasporës, institucioneve kosovare dhe organizatave joqeveritare në Kosovë, dhe vetëm 16.7% e tyre mendojnë se kjo mund të arrihet përmes vazhimit të organizimeve të definuara politikisht.

24 Diskutimet me grupe të fokusuara në Suedi (prill 2007), Gjermani (qershor 2007)

Tabela 17: Mendimi i diasporës lidhur me organizimin e diasporës

Mendimet në lidhje me organizimin e diasporës	
Çfarë do të sugjeronit për organizimin/angazhimin e diasporës?	Percent
Vazhdimi i angazhimeve kryesisht përmes rrymave të partive politike	16.7
Fillimi i lidhjes së klubeve të diasporës	22.6
Bashkëpunimi më i mirë mes klubeve të diasporës, insitucioneve kosovare dhe OJQ-ve në Kosovë	53.9
Të tjerat	3.1
Pa përgjigje	3.7
Total	100.0

Anketa me vizitorë e Riinvest-it, 2006

"... Aktualisht, klubet tona nuk janë duke u frekuentuar nga ne, pasi që ne (diaspora) jemi të pakënaqur me atë që po ndodh, ... asnjë prej liderëve kosovarë nuk ka ardhur këtu për të takuar dhe për të parë nga afër çka jemi duke bërë. Ata vijnë këtu për të takuar anëtarët e tyre politikë, por ne nuk jemi të interesuar të kontribuojmë në këtë mënyrë. Një kohë kemi vepruar si tërësi. Një kohë diaspora ka luajtur rol shumë pozitiv ... ndoshta ne kemi mundësi të mobilizohemi prapë për një të ardhme më të mirë të Kosovës, por kjo është e pamundur për kohën aktuale, duke marrë parasysh kaosin politik në Kosovë... ne mendojmë se organizata, e cila duhet të mobilizojë dhe organizojë diasporën duhet të jetë një organ apolitik". Diskutimet në grupin e fokusuar me familjet në Gjermani (qershor, 2007).

KOMUNITETET E DIASPORËS

Imazhi i Kosovës

Perceptimet lidhur me imazhin e kosovarëve, të cilët jetojnë jashtë vendit, janë diskutuar në grupet e fokusuara me diasporën në vende të ndryshme (Gjermani, Zvicër, Mbretëri të Bashkuar, Austri dhe Suedi). Sipas këtyre diskutimeve, është shumë e vështirë të bëhet një vlerësim i përgjithshëm i imazhit të diasporës, pasi që ata insistojnë se imazhi i tyre në vendet nikoqire ndryshon nga një vend në tjetrin dhe gjithashtu ndryshon nga periudha e emigrimit. Sidoqoftë, kishte një konsensus mes tyre se diaspora kosovare është themeluar dhe është zhvilluar kryesisht gjatë tri periudhave:

1970 dhe 1980: edhe pse pothuajse të gjithë kosovarët që kanë emigruar, kanë qenë të pakualifikuar, ata kanë qenë të njohur si punëtorë të mëdhenj.

1990: gjatë kësaj periudhe ka pasur fluks të madh të azilkërkuesve nga Kosova (kryesisht në Evropën Perëndimore). Rritja e numrit të emigrantëve dhe paraqitja e thyerjes së ligjit në medie nga shqiptarët e Kosovës, ka krijuar një imazh shumë të keq për ta.

Pas vitit 1999: pas luftës, një numër i madh azilkërkuesish janë kthyer në shtëpitë e tyre. Për më shumë, komuniteti i diasporës filloi të kontribuonte më shumë për mirëqenien e tyre dhe integrimin në shoqëritë e vendeve nikoqire. Si rezultat, duke filluar nga viti 2000, imazhi i kosovarëve në vendet nikoqire është përmirësuar gradualisht.

Sipas rezultateve të dala nga diskutimet në grupet e fokusuar, imazhi i shqiptarëve të Kosovës ndryshon nga qyteti në qytet. Në qytetet e mëdha, gjithmonë ka perceptime më të këqija, pasi që atje duket të këtë më shumë mundësi për të pasur raste të thyerjes së ligjit. Në qytetet më të vogla, ata insistojnë që "... vështirë mund të gjendet ndonjë rast ku shqiptarët janë të përmendur në kuptim negativ ...". Sidoqoftë, diaspora kosovare mendon se nuk është duke u prezantuar në mënyrë të drejtë nga mediet e vendeve nikoqire. Sipas tyre, ka një tendencë nga mediet e vendeve nikoqire që të krijojnë stereotipe negative lidhur me shqiptarët e Kosovës, duke i prezantuar ata si shkelës të ligjit dhe fanatikë religjiozë.

"... kur mediet gjermane raportojnë për shqiptarët e Kosovës, zakonisht ata prezantojnë gra me shamia ose pamje me xhami ... ky është imazhi që duhet të ndryshohet ..."

Për më shumë, diaspora në Belgjikë ankohet se nuk ka imazh të mirë atje. Sipas tyre, tregime negative për emigrantët kosovarë paraqiten rregullisht në medie dhe askush nuk reagon rreth kësaj çështjeje. Nuk ka aktivitete të organizuara këtu apo në Kosovë, që do të mund të shërbenin për të përmirësuar imazhin e tyre.

Krijimit të këtij imazhi të keq të kosovarëve gjatë viteve të 90-ta i ka kontribuar gjithashtu edhe propaganda serbe. Kjo propagandë është shpërndarë në mënyrë edhe më të lehtë, kur kemi parasysh që Kosova nuk ka pasur përfaqësues diplomatikë²⁵.

Rasti i diasporës kosovare në Britani të Madhe duket të jetë i ndryshëm nga ato të vendeve tjera të Evropës Perëndimore. Diaspora është relativisht e re dhe për disa arsye ata konsiderojnë imazhin e tyre si të mirë. Së pari, diaspora kosovare në BM është shumë e vogël në krahasim me komunitetet e tjera; së dyti, si pasojë e luftës së viti 1999, ata kanë qenë të trajtuar mirë dhe nuk kanë krijuar probleme gjatë qëndrimit në BM. Për më tepër, diskutimet nxjerrin në pah se pas luftës, refugjatët kosovarë kanë hasur në përkrahje të konsiderueshme nga ana

25 Grupet e fokusuar me familjet në Zvicër (qershor, 2007)

e Britanisë, kur të parët janë pajtuar që me dëshirë dhe në mënyrë paqësore të kthehen në shtëpitë e veta²⁶.

Si përmbledhje, institucionet kosovare dhe mediet duhet të kontribuojnë më tepër në përmirësimin e imazhit të diasporës. Mediet kosovare duhet të luajnë një rol të rëndësishëm. Ato duhet të paraqesin tregimet e suksesshme dhe shkallën e lartë të kontributit të dhënë nga diaspora kosovare. Në këtë aspekt, diaspora nuk duhet të trajtohet si grup i izoluar i shoqërisë, e cila prodhon vetëm krim në vendet nikoqire; në të kundërtën, ajo duhet të trajtohet si një kontribuues i rëndësishëm për shoqëritë e vendeve nikoqire si dhe për vendin amë. Rinia e diasporës duhet të arsimohet dhe të integrohet dhe t'i kontribuojë shoqërisë. Për të lehtësuar këtë, shoqatat në vendet nikoqire duhet të punojnë më për së afërmi me këta të rinj.²⁷

DREJT NDËRTIMIT TË POLITIKAVE AKTIVE TË EMIGRACIONIT

Potenciali emigrues

Presioni për të emigruar duket se po rritet edhe pse me nivele të ulëta. Në vitin 2005, 23.7% e respondentëve të Anketës familjare të Riinvestit kanë pohuar se kanë për qëllim të emigrojnë. Në vitin 2007, 26.2% e respondentëve kanë thënë se shpresojnë të emigrojnë.

ARSYET E EMIGRIMIT

Arsyet ekonomike janë arsyeja primare e emigrimit. Pesëdhjetë e pesë për qind e atyre që shpresojnë të emigrojnë kanë pohuar se pakënaqësia me kushtet aktuale ekonomike të familjeve të tyre është arsyeja kryesore, ndërsa 21.5% e tyre kanë pohuar se situata e përgjithshme ekonomike në Kosovë ishte arsyeja kryesore që i shtyn ata të jenë të gatshëm të emigrojnë, shih Tabelën 20.

Në vitin 1999, arsyet ekonomike ishin shkaku më i përmendur i emigrimit, siç është edhe sot. Sidoqoftë, në vitin 1999, vetëm pak më shumë se çereku i atyre që shpresonin të emigronin, kanë pohuar se arsyeja kryesore që i shtyn ata të emigrojnë ishte situata politike. Një dallim i ndjeshëm, në vitin 2007, më pak se 2 për qind e respondentëve e konsideruan situatën politike si arsyen kryesore që i shtyn ata të shpresojnë të emigrojnë.

²⁶ Bazuar në pjesëmarrësit e grupeve të fokusuar, kanë ekzistuar çështje të tjera që i kanë kontribuar përkeqësimit të imazhit të shqiptarëve të Kosovës dhe ato kanë qenë problemet e krijuara nga shqiptarët e Shqipërisë. Fillimisht, ata (shqiptarët nga Shqipëria) janë prezantuar si të ishin nga Kosova, për të pasur lehtësira në rregullimin e qëndrimit në BM. Sidoqoftë, ky fenomen është identifikuar dhe gradualisht është eliminuar nga autoritetet e BM.

²⁷ Diskutimet nga grupet e fokusuar me familjet në Suedi (mars, 2007).

Tabela 18: Arsyet kryesore që i shtyjnë njerëzit të dëshirojnë të emigrojnë

	Përqindja
Pakënaqësia me kushtet aktuale ekonomike të familjeve	63.26
Ribashkimi familjar	7.65
Pakënaqësia me kushtet aktuale ekonomike	24.66
Pakënaqësia me kushtet aktuale politike	1.7
Të tjera	2.7
	100.0

Anketa me familje e Riinvest-it, 2007

Nuk është e çuditshme që shumë Kosovar mendojnë për të emigruar si rezultat i situatës së tyre ekonomike. Përqindja e popullatës së Kosovës që jetojnë në varfëri është rritur prej 37% në 44% gjatë periudhës 2003-2004²⁸; megjithëqë Indeksi i zhvillimit Njerëzor të Kosovës ka regjistruar përmirësime prej vitit 2001, Indeksi i zhvillimit Njerëzor të Kosovës ishte 0.74 në vitin 2006, që d.m.th. se ishte më i ulëti në Ballkan; dhe me një nivel shumë të lartë të papunësisë në regjion, që ishte përafërsisht rreth 41.4%²⁹. Me 25,000 deri në 30,000 persona të ri që hyjnë në tregun e punës për çdo vit, vetëm një e treta e tyre arrijnë që të punësohen.

Shtetet e synuara për emigrim

Sipas anketës familjare (2007), Gjermania dhe Zvicra janë dy vendet kryesore për Diasporën ekzistuese, si dhe ato gjithashtu janë shtetet kryesore të zgjedhura nga ata që dëshirojnë të emigrojnë, 27.7%, dhe 21.4% respektivisht, shih Tabelën 19.

Tabela 19: Destinimet e menduara të atyre që mendojnë për të emigruar

	Përqindje
Gjermani	29.98
Zvicra	23.18
SHBA	14.42
Britania e Madhe	8.91
Austria	5.83
Tjetër	17.67
	100.0

Anketa me familje e Riinvest-it, 2007

28 ESK, Anketa e Buxhetit Familjar, 2002 dhe 2003/2004

29 ESK, Statistikat e Tregut të Punës, 2005

Vetë fakti që Gjermania dhe Zvicra janë shtetet kryesore të Diasporës ekzistuese dhe objektivi kryesor i të gjithë atyre që dëshirojnë të emigrojnë në këto dy shtete, prandaj kjo është në përputhshmëri me hipotezën që rrjeti përfaqëson një faktor të rëndësishëm tërheqës.

POLITIKAT AKTIVE TË MIGRIMIT DREJT TREGUT TË PUNËS SË BE-SË

Momentalisht Kosovës i mungojnë politika të emigrimit. Me nivelin e lartë të saj të papunësisë (rreth 40%) dhe një potencial të lartë të emigrimit (26% e të anketuarve nga anketa me familje e Riinvestit, si dhe përafërsisht 49.8% e grupmohës 20–35 vjeçe (EWR #18) kanë për qëllim të emigrojnë pothuajse në mënyrë ekskluzive si rezultat i situatës ekonomike në familjet e tyre. Kjo mund të keqësohet nëse kushtet për rritje ekonomike dhe gjenerim të vendeve të reja të punës nuk përmirësohen në mënyrë substanciale.

Analizat e perspektivës së ardhshme tregojnë se me përjashtim të Shqipërisë dhe Kosovës, vendet e tjera të BE-së parashohin zvogëlimin e popullatës deri në vitin 2050. Kjo do të rezultojë në deficit të popullatës me moshë-pune, duke rritur kërkesat për fuqi punëtore të importuar. Net migrimi prej 13.5 milion njerëzve parashihet në BE, ndërsa në Rusi 5.4 milion³⁰.

Aktualisht, në tregun e punës së BE-së ekzistojnë zbrazëtira për plotësimin e nevojave për disa profesione si punëtorët në ndërtimtari, infermierët në spitale, shëndetësi, si dhe kujdesi për persona të vjetër apo pleq, si dhe disa profesione të tjera në sektorin e shërbimeve. Gjithashtu edhe sektorit të Teknologjisë Informative dhe të Komunikacionit i mungon fuqia punëtore e shkathët, prandaj qendrat e thirrjes telefonike dhe mundësitë tjera për sub-kontraktimit mund të jenë plotësuese për këtë. Shembujt e Indisë dhe Pakistanit në këtë fushë mund të jenë të dobishëm. Në Indi ekzistojnë institucione speciale për trajnim, në mënyrë që të plotësojnë kërkesën për punësim të përkohshëm/sezonalë jashtë vendit dhe sub-kontraktimit³¹.

Prandaj ekziston një mundësi që tepricat Kosovare të punëtorëve të punësohen për të mbuluar deficitet në Evropën Perëndimore. Kjo do të ishte në të mirën e të dy palëve, të mirën e Kosovareve dhe të atyre shoqërive që kanë nevojë për këta punëtorë. Megjithatë shfrytëzimi i kësaj mundësie kërkon implementimin e programeve për trajnim dhe arsimim që do të jenë në përputhshmëri me nevojat e shteteve të Evropës për këto aftësi. Ministria e Arsimit dhe e Punës në bashkëpunim me donatorë dhe vendet përkatëse, duhet të zhvillojë programe specifike dhe sisteme të trajnimit për të shfrytëzuar këto mundësi.

Në këtë situatë, krijimi i mundësive për një organizim të përkohshëm (qarkor) institucional të migrimit dhe punësimit sidomos në shtetet e BE-së, bëhet një

30 Përmbledhje e Migrimit në Evropë dhe Azi Qendrore 1990- 2004 (Banka Botërore 52-55)!

31 Intervistat me Z. Vim Peeters (Zyra ndërlidhëse e Belgjikës në Prishtinë) si dhe Znj. Gloria di Luca (Zyra ndërlidhëse e Italisë në Prishtinë).

çështje urgjente. Pas zgjidhjes së statusit politikë dhe sapo procesi i integrimit në BE të fillojë, atëherë Kosova do të jetë e pranueshme për të marrë pjesë në kuotën e BE-së për punësim të përkohshëm (emigrim qarkor). Aktualisht, një numër i Kosovarëve përkohësisht punon në Slloveni në sektorin e ndërtimtarisë. Duke pas parasysh deficitin për punëtorët në tregun e punës së BE-së, se në dekadat e ardhshme, emigrimi dhe punësimi i përkohshëm do të zvogëlonte presionin e madh në tregun e punës së Kosovës. Siç është e cekur më lartë, kjo mundësi duhet të adresohet me politika aktive të tregut të punës, sidomos duke zhvilluar dhe implementuar trajnime fleksibile dhe programe arsimore për plotësimin e kërkesës për aftësi nga tregu i punës së BE-së.

ANEKS 1

PËRFUNDIMET E ARRITURA NGA DISKUTIMET NË GRUPE TË FOKUSUARA

Mungesë e politikave dhe organizimit të qëndrueshëm të diasporës (Grupet e fokusuar me intelektualë)

Grupi i intelektualëve me nivel të lartë të shkathtësive pretendojnë se institucionet e Kosovës nuk i kanë përkrahur ata. Grupi i fokusuar në Vjenë konstaton se marrëdhëniet e emigrantëve/diasporës janë sporadike dhe të paorganizuar. Për më tepër, ky grup ekspertësh tërheq vëmendjen se në rast të marrëveshjeve tregtare, kosovarët preferojnë më shumë që të takohen me ekspertë ndërkombëtarë sesa me kosovarë që jetojnë jashtë Kosovës, edhe nëse këta anëtarë të diasporës kanë kualifikimet e duhura. Për më tepër, ekzistojnë pengesa administrative për rregullimin e dokumentacioneve si dhe për nostrifikimin e diplomave të marra në universitetet e huaja. Sektori privat mund t'i përmbushë kërkesat e tij lidhur me pagat dhe kompensimet financiare, përderisa sektori publik është larg përmbushjes së këtyre nevojave. Motivi kryesor për përfshirjen dhe kontributin e tyre në Kosovë "do të ishte dëshira e tyre që t'i kontribuojnë zhvillimit të Kosovës dhe jo për shkak të përfitimeve financiare – duhet të mbulohen vetëm shpenzimet".

"Kohë më parë, kosovarët iniciuan një projekt të financuar nga Fondacioni Kosovar që përfshinte ekspertët e diasporës. Ky projekt ka vepruar për më tepër se tre vjet. Sidoqoftë, tani ky projekt nuk ka asnjë aktivitet, përveç faqes së internetit. Diaspora kosovare beson se iniciativat e ngjashme do të mund të luanin rol të rëndësishëm si një mekanizëm komunikimi dhe lidhjeje". (Grupi i fokusuar në Londër).

Ngjashëm, grupi i fokusuar në Bruksel sugjeron se diaspora ka një potencial të konsiderueshëm dhe të pashfrytëzuar, që do të mund t'i shërbente zhvillimit të Kosovës. Ata rekomandojnë punësimin e ekspertëve të diasporës në sektorin publik në Kosovë. Kjo do t'i shërbente rritjes së ekspertizës dhe kapaciteteve të qeverisë lidhur me mbledhjen e taksave, pagesave për shërbime publike dhe zhvillimin e programeve kundër korrupsionit.

Remitancat, trendi dhe perspektiva e tyre

Anëtarët e diasporës konstatojnë se, edhe pse niveli i papunësisë në Kosovë është shumë i lartë, aty ende ka mundësi punësimi, posaçërisht në krahasim me vitet e '90-ta. Ata besojnë se niveli i remitancave do të ulet në të ardhmen. Arsyet e rënies së remitancave janë ribashkimi i familjeve me anëtarët e tyre, si dhe punësimi i anëtarëve të familjes në Kosovë. Sidoqoftë, gjendja financiare e

familjeve të tyre në Kosovë mbetet çështje shqetësuese. Një nga pjesëmarrësit thotë: "Ne kemi kaluar 10-12 vjet duke ndihmuar Kosovën dhe tani është koha që të bëjmë diçka për vete". (Kryefamiljarët në Suedi).

Nëpër grupe të fokusuara ekzistonte besimi se dërgimi i remitancave do të vazhdojë gjatë një të ardhme të parashikueshme, në të njëjtin nivel apo me një rënie të vogël. Gjithashtu, ekziston ndjenja se vazhdimi i ndihmës do të fokusohet në mbështetjen e anëtarëve të familjes sesa për përkrahje më të gjerë sociale.

Rrjetet afariste

Në grupet e fokusuara është pohuar se zhvillimi dhe përfundimi i rrjeteve afariste ndërmjet kosovarëve dhe bizneseve të tyre jashtë vendit, si dhe asociacionet e biznesit në Kosovë do të mund të përfundonin mundësitë për lobim. Kjo do të mund të promovonte investimet, tregtinë dhe bashkëpunimin në fushat e tjera, përfshirë bashkëpunimin ndërmjet universiteteve kosovare dhe atyre të huaja. Pjesëmarrësit kanë rekomanduar se në mënyrë që të rriten investimet e jashtme direkte, duhet të krijohen kushte më të mira për investime. (Kryefamiljarët në Suedi).

Institucionet dhe lidhjet e shkëputura me Kosovën (Si të rregullohen dokumentet)

Të gjithë pjesëmarrësit kishin një ankesë të përbashkët, që ishte moskënaqësia me institucionet e Kosovës. Ata ndjehen të injoruar nga institucionet e Kosovës dhe konsiderojnë se ato nuk po i shfrytëzojnë potencialet e diasporës. Për më tepër, ata ndjehen të fyer në Kosovë kur identifikohen si të huaj.

Një çështje e rëndësishme e diskutuar kishte të bënte me udhëtimin dhe dokumentet e tjera. Anëtarët e diasporës ankohen për radhët e gjata në vendet ku lëshohen dokumentet si dhe për kohën e gjatë të lëshimit të tyre. Ata dëshmojnë se afërsisht 20-30% e diasporës kanë vështirësi gjatë udhëtimit. Ata duhet të shpenzojnë një pjesë të madhe të pushimit të tyre, duke rregulluar dokumentacionin. Ata kërkojnë që të ketë më pak procedura të vështirësuar dhe se procedura për rregullimin e dokumenteve të udhëtimit të jetë e shpejtë, posaçërisht gjatë pushimeve të verës dhe dimrit, kur kemi një numër më të madh të vizitorëve nga diaspora.

Një tjetër problem i përmendur lidhet me regjistrimin e pasurive të blera. Në këto transaksione, është e pamundur që të autorizohet ndonjë përfaqësues ligjor për të nënshkruar dokumentacionin. Kjo u krijon probleme anëtarëve të diasporës, të cilët nuk kanë mundësi që të largohen nga puna e tyre për të udhëtuar në Kosovë, sa herë që kanë nevojë për të kompletuar transaksione për patundshmëri. (Kryefamiljarët në Bruksel).

Pjesëmarrësit ankohen se ka një mungesë të aktiviteteve kulturore, me përjashtim të disa mbrëmjeve muzikore, ku pjesëmarrës janë këngëtarë nga Kosova. Sërish ata ndjehen të injoruar nga Qeveria dhe populli i Kosovës.

"Përkrahja e diasporës jo që është e dobët, por ajo nuk ekziston fare... ne jemi lënë pa ndonjë përkrahje dhe kujdes: ne nuk jemi të mbështetur nga institu-

cionet e Kosovës dhe të gjithë kanë harruar se një kohë diaspora ishte shumë e organizuar dhe se e njëjta mund të kontribuojë shumë". (Një afarist nga Gjermania).

"Tetë vjet kanë kaluar dhe askush nuk e përmend apo pranon se ne jemi ata që kemi përkrahur Kosovën dhe familjet tona. Unë do të vazhdoj të përkrah familjen time, por nuk do të jap as edhe një cent për institucionet e Kosovës".

"Asnjë lider i institucioneve të Kosovës nuk na viziton. Edhe nëse vijnë, ata takohen me anëtarët e tyre partiakë. Ne trajtohem si të huaj në Kosovë dhe të tillë do të trajtohem përherë në vendet ku jetojmë".

"... Tani klubet e diasporës nuk vizitohen si më parë; jemi të dëshpëruar. Asnjë lider nga Kosova nuk na viziton apo informon lidhur me ngjarjet në Kosovë. Dikur ishim të bashkuar dhe vepronim shumë mirë. Lufta ishte një detyrë e rëndë për çdonjërin dhe diaspora ka luajtur një rol të rëndësishëm për të fituar luftën. Ne do të mund të organizoheshim prapë për të ndihmuar Kosovën, por mendoj se kjo është e pamundur, duke pasur parasysh kaosin politik në Kosovë. Mendoj se struktura që do të organizonte diasporën duhet të jetë politikisht e pavarur dhe jo e ndarë"(Kryefamiljarët në Gjermani).

"Ne shqetësohem se do të humbim lidhjet me kulturën tonë dhe kemi përshlytjen se nuk ka qeveri që të na mbrojnë". (Kryefamiljarët në Bruksel).

Diaspora nuk ndjehet mirë me pseudonimet qesharake që u vihen nga kosovarët dhe me mosmirënjohjen ndaj tyre, për çdo gjë që kanë bërë në përkrahje të Kosovës. Ata dëshmojnë se ndjihen si të huaj sesa si kosovarë (gjenerata e dytë/tretë suedez). Ata shpesh i dëgjojnë kosovarët duke thënë "qëkur kanë ardhur ata nga jashtë, nuk ka mbetur vend për të dalur". "Pasi të kthehem nga Kosova jemi më të pakënaqur dhe anketa do ta dëshmojë një gjë të tillë." (Kryefamiljarët, Londër). Ekziston përshtypja se nganjëherë ekspertët nga diaspora konsiderohen si konkurrencë dhe kërcënim sesa si partnerë dhe bashkëpunëtorë potencialë.

Turizmi i diasporës

Pjesëtarët e diasporës bëjnë ftesë për marrjen e masave që do të ofronin pushime më të këndshme në Kosovë. Ata besojnë se duke bërë aq shumë për Kosovën, ajo duhet t'u ofrojë tretman dhe shërbim më të mirë. Pushimet verore konsiderohen si mënyrë për të përforcuar lidhjet familjare, posaçërisht për të njoftuar fëmijët nga diaspora me atdheun dhe gjuhën e tyre, kulturën dhe historinë. Për më tepër, ofrimi i shërbimeve të duhura për diasporën do të mund të ishte një mundësi e mirë e afarizmit për bizneset vendore. (Kryefamiljarët – Londër).

Bazuar në një agjenci turistike në Bruksel, janë rreth 60,000 kosovarë që jetojnë në Belgjikë dhe udhëtojnë të paktën një herë në vit për në Kosovë. Rreth 20% e tyre udhëtojnë me aeroplan dhe të paktën 60% e tyre udhëtojnë me vetura. Vlerësohet se një vizitë e anëtarëve të diasporës në Kosovë kushton 4,500-5,000 euro. Nga kjo shifër, 20 për qind janë shpenzime transporti; 15-20% në investime dhe mirëmbajtje; 30-40% në ushqim; 30-40% në dhurata dhe shpenzime të tjera. Për shumicën e tyre, aty përfshihen edhe shpenzimet e pushimit 10

ditor në Ulqin/Durrës (rreth 1.500 euro). Bazuar në këtë, mund të vlerësohet se ata shpenzojnë 2000–2500 euro në Kosovë. Shumica e tyre mendojnë se ndikimi më i madh financiar buron nga vizitat e tyre. Çuditërisht, ata thonë se mungojnë ngjarjet kulturore, kurset e gjuhëve, ekskursionet për fëmijë nëpër vende turistike dhe historike. (Kryefamiljarët – Bruksel). Një vajzë tregon se kur i është drejtuar komunës së Mitrovicës për informata lidhur me vendet turistike, ajo nuk ka marrë asnjë informatë. (Gjenerata e dytë–Suedi). Sidoqoftë, paratë tona janë vetëm transit në Kosovë, pasi që ato shkojnë për import nga Greqia dhe Turqia. (Grupi i fokusuar–Londër).

Biznesi dhe komunikimi

Një afarist ka deklaruar se disa projekte kanë dështuar si pasojë e komunikimit të pakënaqshëm me institucionet në Kosovë. "Për shkak të kësaj arsyeje, pavarësisht dëshirës sime për të investuar në Kosovë, unë kam investuar në Zvicër". Ekziston nevoja për përkrahje institucionale për investitorët. "Ne kemi shkuar në Kosovë për të parë mundësitë e investimeve dhe kemi kaluar tre ditë me radhë dhe askush nuk ka pasur kohë për ne". Për këtë arsye, ata thonë se ekziston nevoja që diaspora të informohet lidhur me programet zhvillimore. Për shembull, pavarësisht prej kontributit të madh të tyre, ata ndjehen të neglizhuar gjatë procesit të privatizimit.

Taksat konsiderohen si të larta krahasuar me vendet e rajonit. Një barrierë tjetër e zhvillimit konsiderohet konkurrenca jolegale në treg. Disa pjesëmarrës sugjerojnë krijimin e një fondi për zhvillim nga diaspora, dhe për më tepër të krijohet një qendër për koordinimin e diasporës në Kosovë.

Zbatimi i ligjit dhe korrupsioni

Pengesa kryesore ndaj investimeve të diasporës është mungesa e zbatimit të ligjit dhe korrupsioni i vazhdueshëm. Prezenca e korrupsionit është penguesi më i madh i investimeve të diasporës. Po ashtu, nepotizmi konsiderohet si problem i institucioneve të Kosovës, i cili duhet adresuar. Sistemet joadekuate të shkollimit dhe shëndetësia janë faktorë që dekurajojnë përfshirjen në Kosovë. (Bruksel).

Imazhi i Kosovës

Pjesëmarrësit thonë se në qytete apo komunitete të vogla, shqiptarët e Kosovës kanë imazh të mirë, por jo edhe në komunitetet e mëdha. Disa besojnë se kjo është pasojë e propagandës së vazhdueshme të Serbisë në të kaluarën, dhe ndoshta edhe tani. "Sa herë që përmenden shqiptarët e Kosovës nëpër medie, shfaqen pamje të një gruaje me shami duke nënkuptuar se jemi të ndërlidhur me myslimanë". (Gjenerata II/III në Zvicër). Mediet përdoren që të paraqesin imazhe të rrejshme dhe mungon një reagim i duhur si nga institucionet kosovare, ashtu edhe nga komunitetet e diasporës. Komunitetet tona duhet të krijojnë një rol lobues dhe të bashkëveprojnë më shumë me komunitetet lokale. Kjo do t'i kontribuonte përmirësimit të imazhit tonë.

ANEKSI 2: STUDIM RASTI I TRI FIRMAVE TË PRIVATIZUARA NGA DIASPORA

Kompania 1: Trofta

Vendi: Istog

E privatizuar më: 2003

Madhësia: E mesme (80-100 punëtorë)

Industria: Peshkatori, hotele dhe restorante

I intervistuari: Pronari (nga diaspora)

Kompania Trofta është privatizuar në valën e tretë të privatizimit. Kompania përbëhet nga një njësi e kultivimit të peshkut, një hotel dhe një restorant. Pronari vlerëson që gjysma e kërkesës për peshk në Kosovë përbëhet nga importet dhe pjesa tjetër nga konsumi vendor. Trofta ofron në treg rreth 90% të peshkut të kultivuar në tregun vendor. Pronari i troftës ka jetuar në Bruksel që nga viti 1981. Ai ka përfunduar fakultetin e bujqësisë në Prishtinë. Në Bruksel, pronari i troftës ka qendra për servisim të automjeteve dhe garazhe.

Kur ka filluar procesi i privatizimit në Kosovë, pronari ka vendosur të blejë kompaninë Trofta, e cila gjendet në qytetin ku ai është rritur. Arsyja kryesore për investim ishte dëshira e tij për të kontribuar në zhvillimin ekonomik të Kosovës. Përveç kontributit të drejtpërdrejtë, ai ka shpresuar që kjo blerje do të dërgonte sinjal te investuesit e huaj se Kosova është vend i sigurt dhe këtu e vlen të investohet. Për shkak të problemeve burokratike në AKM, nuk kanë mundur të bëhen përmirësime në firmë në shtatë muajt pas blerjes. Pas kësaj periudhe të paqartësive, pronari është lejuar të fillojë aktivitetet. Pasi që kompania ka qenë në gjendje shumë të keqe, pronari është dashur të bëjë investime shtesë në hotel dhe kultivim të peshkut. Vlera e këtyre investimeve ka qenë rreth 2.5 milionë euro. Investimet janë bënë në rindërtim të pronës dhe në teknologji të re, kryesisht të importuar nga jashtë. Kompania menaxhohet nga dy vëllezërit e pronarit dhe me vizita të shpeshta të tij. Kompania momentalisht ka 80 punëtorë. Gjatë verës, ky numër ngritet në 100. Të punësuarit në njësinë e prodhimit janë trajnuar në Gjermani dhe Danimarkë.

Ushqimi dhe koncentratet për kultivim të peshkut janë importuar nga Danimarka, e cila është prodhues kulminant i peshkut. Ky biznes është i ri për pronarin. Për t'u siguruar që zbatohen praktiket më të mira, pronari shfrytëzon shërbime konsultimi nga Gjermania. Përveç kësaj, procesi i kultivimit ka përfituar nga vizitat e pronarit në fabrika moderne të peshkut në Francë dhe Belgjikë. Këto përpjekje kanë ulur dukshëm normat e ngordhjes, veçanërisht atë të peshqve nën 5 muaj, dhe kanë ngritur kapacitetin nga 80 tonë në vitin 2004, në mbi 300 tonë.

Pronari ka deklaruar që përveç teknologjive dhe praktikave të reja të punës, ai ka përhapur një kulturë të re të punës dhe mentalitet të ri, e cila thekson cilësinë dhe përgjigjësinë të të gjithë punëtorët. Ai beson se ka kjo nismë ka qenë e suksesshme në kompani.

Kur është pyetur nëse ia ka vlejtur/vlen të investohet në Kosovë, pronari është përgjigjur si vijon: "E vlen në kuptim që mund të ndikojë te të tjerët jashtë vendit që të investojnë, por nga ana tjetër, nuk e vlen të investohet sepse tregu është shumë i vogël. Një përparësi e të operuarit në Kosovë është politika fiskale e favorshme në krahasim me aktivitetet biznesore në Bruksel".

Kur është pyetur për pengesat për zhvillim të bizneseve në Kosovë, pronari ka deklaruar që problemi kryesor është statusi i pazgjidhur i Kosovës. Problemi tjetër në radhë ishte konkurrenca jolojale. Pronari nuk beson që Qeveria duhet të kufizojë konkurrencën nga jashtë, por që peshku i importuar duhet t'i nënshtrohet inspektimit sanitar nga dogana dhe autoritetet e tjera kufitare. Ai ka deklaruar se mungesa e inspektimit të peshkut të importuar dhe korrupsioni ulin çmimin e shitjes së peshkut dhe i vendos në pozitë jo të favorshme prodhuesit vendorë siç është Trofta. Përfundimisht, pronari ka cituar mungesën e punëtorëve të kualifikuar si pengesë për zhvillim.

Kompania 2: Kosova Steel

Vendi: Pejë

E privatizuar më: 2005

Madhësia: E mesme (80 punëtorë)

Industria: Prodhimi i metaleve bazë dhe prodhimi i makinerisë dhe pajisjeve

Kosova Steel (ish-Zastava) është privatizuar në valën e nëntë të privatizimit në dhjetor 2005. Sipas pronarit të kompanisë, kjo është punishtja më e madhe për prerjen e metalit në Ballkan dhe, po ashtu, ka prerësin më të madh në Ballkan. Kjo kompani është e orientuar kryesisht në tregje të eksportit, prej të cilave më e rëndësishmja është prodhimi i pjesëve të metalit për fabrika të Italisë. Megjithëse kërkesa për produktet e saj në tregun e Kosovës konsiderohet e ulët, firma prodhon disa produkte për konsum vendor, siç janë pjesë të traktorëve, pastrues të borës dhe kontejnerë të mbeturinave.

Pronari është nga Kosova dhe ka jetuar në SHBA, që nga viti 1988. Ai ka studiuar matematikën, në Shkollën të Lartë në Prishtinë dhe pastaj ka kryer trajnime për biznes në SHBA. Në SHBA, pronari ka një agjenci për qiradhënie, e cili ka funksionuar që nga viti 1994. Megjithëse ka jetuar me familjen e tij në SHBA, për një kohë të gjatë dhe ka pasur biznes të suksesshëm, ai ka qenë i gatshëm të kontribuojë në zhvillimin ekonomik të Kosovës dhe e ka blerë kompaninë Kosova Steel. Kjo kompani menaxhohet nga vëllai i tij, i cili jeton në Pejë dhe, po ashtu, edhe vetë nga pronari, përmes vizitave të shpeshta në kompani, pesë deri në dhjetë herë në vit.

Për të filluar prodhimin, pronari është dashur të bëjë investime shtesë në vlerë rreth një milion euro. Pjesa më e madhe e punëtorëve të kompanisë së vjetër janë mbajtur në punë, për shkak të përvojës së tyre në këtë industri. Për të rritur produktivitetin, punëtorët janë trajnuar në Itali, kurse ekspertë nga Gjermania janë angazhuar për konsultime. Për shkak të kërkesës së ulët në Kosovë, biznesi kryesisht është orientuar drejt tregut ndërkombëtar, veçanërisht në Itali. Kjo kompani ka marrëveshje me kompanitë në Itali për të shitur produkte

në baza kontingjenti. Për të përmbushur nevojat për punëtorë të shkathtësuar, kompania planifikon të themelojë një shkollë profesionale private për t'i pajisur të rinjtë me shkathtësitë e domosdoshme për t'i zhvilluar aktivitetet në këtë industri.

Ndërmarrja 3: Kombinati i Drurit

Vendi: Pejë

Privatizuar: në vitin 2003

Madhësia: (100-150 punëtorë)

Industria: Përpunimi i drurit dhe produktet e tjera të drurit

Intervistuar: Përfaqësuesi i ndërmarrjes

Kombinati i Drurit është privatizuar në vitin 2003. Prodhon dërrasa dhe shtretër për tregun e jashtëm. Pronarët e fabrikës kanë jetuar në SHBA mbi 30 vjet. Ata janë arsimuar në SHBA dhe kanë një biznes të shkëlqyeshëm të paluejtshëmrisë, ata lëshojnë apartamente dhe shtëpi me qira. Motivimi primar i tyre për të investuar në Kosovë ishte për të asistuar në zhvillimin ekonomik të saj. Firma menaxhohet nga stafi që jeton në Pejë, kurse pronarët vizitojnë Kosovën tri deri katër herë në javë. Të dy pronarët nuk kanë përvojë të mëhershme në këtë industri.

Megjithëqë ndërmarrja ishte privatizuar në vitin 2003, ajo filloi të punojë në vitin 2006. Arsyja për këtë fillim me vonesë, ishte nevoja për të siguruar blerësit për produktet e tyre para se të merrnin përsipër përfundimisht fillimin e procesit të prodhimit. Gjatë kësaj faze përgatitore, ndërmarrja ka angazhuar konsulentë nga Gjermania për të dhënë asistencën e tyre, në lidhje me atë se si është më së miri për të shfrytëzuar dhe për të përmirësuar makinerinë ekzistuese si dhe për të ngritur cilësinë e produkteve.

Lënda e parë sigurohet në tregun e Kosovës. Si rezultat i tregut të vogël vendor, Kombinati i Drurit ka qenë kryesisht i orientuar drejt tregjeve ndërkombëtare. Ndërmarrja eksporton prodhime të drurit, si dërrasa në Izrael, Kinë dhe Dubai, dhe shtretër në Zvicër, Itali, Austri, Gjermani, Sllovaki dhe Greqi.

Pronarët me këtë biznes janë të kënaqur përderisa reputacioni i kësaj ndërmarrjeje është në rritje, prandaj ata presin një trend të vazhdueshëm të rritjes që do të ketë efekt në përmirësimin e kualitetit të produkteve të tyre. Si me pronarët e tjerë të intervistuar, edhe këta pronarë besojnë që statusi i pazgjdhur i Kosovës është problemi më i madh i tyre. Problemi tjetër është nevoja për të marrë me qira kamionë të shteteve të tjera për të transportuar produktet e tyre, sepse nuk ka kamionë për këtë çështje në vend.

NJË INVESTITOR POTENCIAL NË DIASPORË, POR HEZITANT PËR TË INVESTUAR NË KOSOVË

Agim Kalenderi , tani një 46 vjeçar, morri rrugën e emigrimit para 26 vitesh i shtyrë nga ndjenja e mosperspektivës dhe pasigurisë, duke i lënë studimet përgjysmë në degën e anglishtes dhe familjen e tij në Prizren. Ai krijoi familjen pas dy vjeteësh qëndrimi në Bruksel, ku kishte filluar të punonte. Përmes lidhjeve familjare ai njihet me pronarin kryesor të firmës "Van de Castele nv" kompani e mirënjohur në tregti me pemë dhe perime në Belgjikë. Kjo kompani kishte nevojë për një bashkëpunëtor për tregun e Turqisë, për të cilën pozitë u punësua Agimi. Pas katër viteve punë Agimi arrin të bëhet drejtor i shitjes së kësaj kompanie të madhe. Kjo kompani integrohet me kompaninë tjetër të madhe UNIVEG Group nv, një aktor kyç i shitjes së pemëve dhe primeve në nivel Europian me qarkullim me mbi 3 miliardë Euro në vit. Pronari i ofron pozitën e drejtorit gjeneral dhe kushte tjera shumë atraktive. Pasi bëri një rrugëtim të suksesshëm, Agimi vendosi të themelojë firmën e vet (New Fruit Company- NFC) në të njëtin sektor- furnizim me pemë dhe perime të freskëta. Kompania NFC me 10 të punësuar, të gjithë nga Kosova (duke përfshirë edhe vellaun e Agimit) realizojnë shitje vjetore prej 50 milion Euro si furnizues i rendësishëm i dyqaneve të vogla dhe të mëdha në Belgjikë. Të gjithë të punësuarit e tij i kanë familjet me vete dhe realizojnë paga për 20% më të larta se sa punëtorët në firmat e ngjashme.

Po cilat janë lidhjet e tij me Kosovën? Agimi përgjigjet: "shumë emocionale". Kujdeset për prindërit pensionistë dhe ka ndërtuar një shtëpi të bukur në Prizren dhe një tjetër tek Mali i Robit në Durrës. Ai viziton prindërit çdo 4-5 muaj dhe jeton me Kosovën në preokupime. Por kur kalon në rrafshin racional prej nga duhet të gjykojë një biznesmen tek ai ende shfaqen hezitime për të investuar në Kosovë. Gjendja në infrastrukturë, konkurrenca joformale dhe ekonomia e zezë, apo thënë ndryshe problemet me ndërtimin e shtetit ligjor janë ato probleme që i dalin pengesë atij në rrugën për të investuar në Kosovë. Thotë se nuk është i gatshëm të funksionojë dhe menaxhojë biznesin ndryshe përpos në kushtet e sigurisë juridike, fizike dhe konkurrencës së drejtë, dhe në këtë aspekt ende nuk sheh progres të duhur në Kosovë. Sa i përket taksat ai thotë se nuk është problemi kryesor të lartësia e taksave: " taksat më të volitshme se sa në Belgjikë" por problemi është kur detyrohesh të paguash 26% në kufi ende pa realizuar aktivitetin ekonomik. "Kjo është e çuditshme për një vend që i duhen aq shumë investimet!", gjë që duhet ndryshuar.

Me një autoritet të ndërtuar dhe biznes stabil Agimi mbetet hezitues për të investuar në Kosovë... Ai megjithatë ka vendosur për ta dërguar djalin e tij në studime në një nga universitetet në Kosovë që të forcojë lidhjet me atdheun dhe përsos gjuhën shqipe.

(Intervistë me zotëri Agim Kalenderi, Pronar i Neë Fruit co. Bruksel , Korrik 2007)

BIBLIOGRAFIA

- Beilock, R. (2000), The Impact of Caring on Exchange Choices and Efficiencies: A modification of Boulding's Three Social Organizers, *Journal of Socio-Economics* 29
- CBAK (2007) Monthly Macroeconomic Monitor, Prishtina.
- Gedeshi (2002), Role of Remittances from Albanian Emigrants and Their Influence in the Country's Economy, *Eastern European Economics*, 40, 5.
- Hergnyan, M. and Makaryan, A. (2007), The Role of Diaspora in Generating Foreign Direct Investments in Armenia, <http://ev.am/EVRC-RoleofDiasporainFDI-inArmenia-FINAL-12-04-06.pdf>.
- Raporti i Zhvillimit Njerëzor (2006), UNDP.
- Hunte, C. K. (2004), Workers' Remittances, Remittance Decay and Financial Deepening in Developing Countries, *The American Economist* 48, 2.
- Instituti Riinvest (2003), papunësia dhe Tregu i Punës në Kosovë, Raport Hulumtues.
- IMF (2007), Aide mémoire of the IMF Staff Mission to Kosovo, February 19-27, 2007, IMF.
- Ketkar, S. L. and Ratha, D. (2007), Development Finance via Diaspora Bonds: Track Record and Potential, <http://siteresources.worldbank.org/INTPROSPECTS/Resources/334934-1100792545130/Diasporabonds.pdf>.
- Lucas, R.B.E. (2005) International Migration and Economic Development: Lessons from Low-Income Countries, http://www.egdi.gov.se/pdf/International_Migration_and_Economic_Development.pdf.
- Neyapti, B. (2004), Trends in Workers' Remittances: A Worldwide Overview, *Emerging Markets Finance and Trade*, 40, 2.
- Raporti i Paralajmërimit të Hershëm, Nr. 18, (2007), UNDP.
- Rivera-Batiz, F. (2001), International Migration, Remittances, and Economic Welfare in the Source Country, *Journal of Economic Studies* 13, 3.
- Roberts, B. W. and Bainain, K. (2005), Remittances in Armenia I: How Big are Remittance Flows to Armenia and how Much does it Cost to Send them? *Armenian Journal of Public Policy*, or http://www.aiprg.org/UserFiles/File/journal/AJPP_3_4.pdf
- Ruggerio, E. (2005), Migration and Remittances: A Micro Perspective, *Problems of Economic Transition*, 48, 3.
- Skeldon, R., 2003, Poverty and Migration. Paper presented at the conference on "African Migration and Urbanization in Comparative Perspective, Johannesburg, South Africa, June 4 – 7, 2003.
- World Bank (2006), Global Economic Prospects: Economic Implications of Remittances and Migration, Washington DC.
- World Bank (2007), Migration and remittances: Eastern Europe and the Former Soviet Union, Washington DC.

PËR FORUM 2015

Forum 2015 është një projekt i Fondacionit SOROS dhe Institutit RIINVEST, që ofron ekspertizë dhe avokon për çështjet zhvillimore në Kosovë. Forum 2015 përmes aktiviteteve të ndryshme, nxit debate mbi tema aktuale dhe ndihmon zhvillimin e një kulture të avancuar politike. Në perspektivë të gjerë, Forum 2015 synon përgatitjen e Kosovës për integrim në struktura Euro-Atlantike.

TRYEZAT E DERITASHME TË DISKUTIMEVE (SEMINARET DHE KONFERENCAT)

Puna e Kuvendit të Kosovës 2004-2007 (dokumentar) – Nëntor, 2007
 Platforma Civile për Zgjedhjet 2007 – 31 Tetor 2007
 Identiteti Evropian i Kosovës – 26 & 27 Qershor 2007
 Politika e Jashtme e Kosovës pas statusit – 9 Maj 2007
 Një Përrallë Moderne – Kosova C 2100 – 18 Prill 2007
 Statusi pas statusit - Prezenca e ardhshme ndërkombëtarë në Kosovë – 14 Dhjetor 2006
 Arsimi bazik cilësor në funksion të zhvillimit njerëzor – 10 Nëntor 2006
 Dialogu i decentralizimit në Kosovë – 14 Qershor 2006
 Arsimi i lartë për minoritetet në Kosovë – 18 Maj 2006
 Kultura fiskale dhe qëndrueshmëria buxhetore – 19 Janar 2006
 60 vjetori i OKB-së – Një zhvillim për të gjithë – 24 Tetor 2005
 Statusi kundër status quos – 1 Qershor 2005
 Mediat në Kosovë: sfidat e gazetarisë së pavarur dhe të qëndrueshme – 21 Mars 2005
 Kosova dhe integrimi i saj në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë – 23 Dhjetor 2004
 Kosova pas pesë vitesh: cila është ardhmëria? – 9-10 Korrik 2004
 Statusi i pronës shoqërore në Kosovë: kontestet dhe privatizimi – 4 Qershor 2004
 Privatizimi në Kosovë: mbarëvajtja dhe pengesat – 9 Mars 2004
 Sistemi zgjedhor në Kosovë: përparësitë dhe të metat – Shkurt 2004
 Operacionalizimi i standardeve – 26 Nëntor 2003
 Platforma e dialogut Prishtinë-Beograd – 7 Tetor 2003
 Samiti i Selanikut – sfidat e integritimit evropian – 11 Qershor 2003

PUBLIKIMET E DERITASHME

Puna e Kuvendit të Kosovës 2004-2007 (dokumentar) – Nëntor, 2007
 Identiteti Evropian i Kosovës – Nëntor, 2007
 Platforma Civile për Zgjedhjet 2007 – Tetor, 2007
 Politika e Jashtme e Kosovës – Shtator, 2007
 Një Përrallë Moderne – Kosova C 2100 – Prill, 2007
 Statusi pas statusit – Prezenca ndërkombëtare në Kosovë – Shkurt, 2007
 Decentralizimi në Kosovë – Manual informativ – Janar, 2007
 Arsimi bazik cilësor në funksion të zhvillimit njerëzor – Nëntor, 2006
 Arsimi i lartë për minoritetet në Kosovë – Shtator, 2006
 Kosova pesë vite më vonë – Çfarë agjende për të ardhmen? – 2005
 Pse pavarësia? – Shtator, 2005
 Privatizimi në Kosovë – Përparimet dhe ngecjet – Mars, 2004

Për më tepër www.forumi2015.org

